

INSTRUMENTET E BASHKIMIT EVROPIAN PËR LUFTË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR



Jellena Babiq Barnes



BCSP Belgrade Centre
for Security Policy

Shtator 2020

INSTRUMENTET E BASHKIMIT
EVROPIAN PËR LUFTË
KUNDËR **KRIMIT TË ORGANIZUAR**



Jellena Babiq Barnes



BCSP Belgrade Centre
for Security Policy

Shtator 2020

INSTRUMENTET E **BASHKIMIT EVROPIAN** PËR LUFTË KUNDËR **KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Botues

Qendra e Beogradit për Politikë të Sigurisë (BCBP)

Adresa: Đure Jakšića 6/5, Beograd, Serbi

Internet: www.bezbednost.org

Email: office@bezbednost.org

Autor

Jellena Babiq Barnes

Redaktor

Sasha Gjorgjeviq

Recensent

Srgjan Majstoroviq

Lekturimi

Allisa Kolenshiq Radiq

Dizajni dhe faqosja

Srdjan Iliq

Mohim i përgjegjësisë

Mendimi i shprehur në këtë botim nuk përfaqëson mendimin e Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë në Beograd ose të Fondit Ballkanik për Demokraci, as të Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij.

Beograd, shtator 2020.

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Norwegian Embassy

Belgrade

Publikimi i këtij botimi u mbështet nga Fondi Ballkanik për Demokraci, projekti i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Beograd.

Table of Contents

Shkurtesat dhe akronimet	6
Hyrje	9
Prioritetet e BE-së në luftën kundër krimit të organizuar	11
Prioritetet e BE-së në luftën kundër krimit të organizuar për periudhën 2018-2021	11
Si funksionon Cikli i Politikës së BE-së (EMPACT)	12
Korniza institucionale e BE-së për luftën kundër korrupsionit	14
Komisioni Evropian: Drejtoria e Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme	14
Komiteti i Parlamentit Evropian për Liri Civile, Drejtësi dhe Punë të Brendshme (LIBE)	17
Komiteti i Përhershëm për Siguri të Brendshme (COSI)	19
Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (EUROPOL)	21
Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Drejtësi Penale (EUROJUST)	24
Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Organeve për Zbatimin e Ligjit (CEPOL)	27
Agjencia Evropiane për Kontrollin e Kufijve dhe Roje Bregdetare (FRONTEX)	29
Qendra Monitoruese Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave (EMCDDA)	31
Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF)	33
Rrjeti Gjyqësor Evropian për Çështje Penale (EJN)	35
Rrjeti Evropian për Parandalimin e Krimit (EUCPN)	37
Agjencia e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Sistemeve të Mëdha Informative në Fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë (eu-LISA)	38
Instrumentet e Bashkimi Evropian për Luftën kundër Krimit të Organizuar	41
Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar në BE (SOCTA)	41
Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar në Internet në BE (iOCTA)	42
Praktika e shkëmbimit të informatave në BE	44
Urdhër Arresti Evropian	47
Urdhri Evropian për Inicimin e Hetimit	49
Literatura shtesë	51
Bibliografia	53

Shkurtesat dhe akronimet

AFIS	Sistemi Informativ për Luftë Kundër Mashtrimeve
CEPOL	Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Organeve të Zbatimit të Ligjit
CoEU	Këshilli i Bashkimit Evropian
COSI	Komiteti i Përhershëm për Siguri të Brendshme
DG	Drejtoria e Përgjithshme
DG HOME	Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Migracion dhe Punë të Brendshme
EAW	Urdhër Arresti Evropian
EC	Komisioni Evropian
EC3	Qendra Evropiane për Krim Kompjuterik
ECA	Gjykata Evropiane e Auditorëve
ECRIS	Sistemi Informativ Evropian i Regjistrave Penal
ECRIS-TCN	Sistemi Informativ Evropian i Regjistrave Penal i shtetasve të vendeve që nuk janë anëtare të BE-së
ECTC	Qendra Evropiane për Luftimin e Terrorizmit
EDPS	Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
EEAS	Shërbimet Evropiane për Veprim të Jashtëm
EES	Sistemit Evropian për Regjistrimin e Hyrjes/Daljes
EIO	Urdhri Evropian për Inicimin e Hetimit
EIS	Sistemi Informativ i Europol-it
EJCN	Rrjeti Gjyqësor Evropian për Krim Kompjuterik
EJN	Rrjeti Gjyqësor Evropian
EMCDDA	Qendra Monitoruese Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave
EMPACT	Platforma Multidisiplinare Evropiane për luftën kundër kërcënimeve të krimit
EMSC	Qendra Evropiane për Luftimin e Trafikimit të Migrantëve
EP	Parlamenti Evropian
EPE	Platforma e Europolit për Ekspertë
EPPO	Zyra e Prokurorit Publik Evropian
ETIAS	Sistemi Evropian për Informata dhe Autorizime të Udhëtimit
EU	Bashkimi Evropian (BE)
EUCPN	Rrjeti Evropian për Parandalimin e Krimit
eu-LISA	Agjencia e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Sistemeve të Mëdha Informative në Fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë

EUROJUST	Zyra Evropiane për Bashkëpunim në Drejtësi Penale
EUROPOL	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit
EUROSUR	Sistemi Evropian për Mbikëqyrjen e Kufijve
FRONTEX	Agjencia Evropiane për Kontrollin e Kufijve dhe Roje Bregdetare
iOCTA	Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar në Internet në BE
IPA	Instrumenti i Ndhmës së Para - Aderimit
IPC3	Koalicioni i Koordinuar për Luftimin e Shkeljes së Pronës Intelektuale
ISF	Fondi për Siguri të Brendshme
JITs	Ekipet e Përbashkëta Hetimore
JPSG	Grupi i Përbashkët Parlamentar për Mbikëqyrje
LIBE	Komiteti i Parlamentit Evropian për Liri Civile, Drejtësi dhe Punë të Brendshme
MASP	Plani Strategjik Shumëvjeçar
NCC	Qendra Kombëtare për Koordinim
NEC	Koordinatori Kombëtar për EMPACT
OAP	Plani Operativ i Veprimit
OCTA	Vlerësimi i Kërcënimit të Krimin të Organizuar
OLAF	Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit
PIU	Njësitë e Mbledhjes së Informatave për Udhëtarët
PNR	Regjistri i Emrave të Udhëtarëve
REITOX	Rrjeti Evropian i Informacionit mbi Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave
SIENA	Aplikacioni i rrjetit për shkëmbim të sigurt të të dhënave
SIRENE	Kërkesa për informata shtesë gjatë hyrjes së personave në shtetet anëtare të BE-së
SIS	Sistemi Informativ i Shengenit
SOCTA	Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Rëndë dhe i Organizuar
TFEU	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
VIS	Sistemi Informativ për Viza
WB	Ballkani Perëndimor

Hyrje

Studimi arsimor-politik me titull “Instrumentet e Bashkimit Evropian (BE) në luftën kundër krimit të organizuar” u përgatit nga Qendra e Beogradit për Politikë të Sigurisë. Ajo është pjesë e projektit “Radari i Krimit të Organizuar në Ballkanin Perëndimor” (WB-OCR), me synimin për të kapërcyer hendekun midis angazhimeve të cilat qeveritë në Ballkanin Perëndimor (WB6) kanë marrë përsipër kur bëhet fjalë për luftën kundër krimit të organizuar dhe rezultatet e tyre jo bash të mira në terren.

Qëllimi i studimit arsimor-politik është prezantimi para publikut të gjerë i informacionit më të rëndësishëm dhe më të ri mbi zgjidhjet politike, legjislativonin dhe kornizat institucionale që Bashkimit Evropian i shërbejnë si bazë për të luftuar krimin e organizuar.

Studimi përbëhet nga tri pjesë. Kapitulli i parë përmban një përmbledhje të shkurtër të prioriteteve dhe politikave kryesore të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar për periudhën 2018-2021. Dy kapitujt vijues i bëjnë të njohur lexuesit kornizën institucionale të BE-së për luftën kundër krimit të organizuar dhe instrumentet kryesore të krijuara deri më sot për të ndihmuar në identifikimin dhe kapërcimin e kërcënimeve të paraqitura nga krimi i rëndë dhe i organizuar dhe për të forcuar bashkëpunimin midis shteteve anëtare.

Autori, në lidhje me të gjitha institucionet, instrumentet dhe zgjidhjet politike të lartpërmendura dhe të përshkruara, ka shqyrtuar hollësisht aktet ligjore të BE-së që zbatohen në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, si dhe materien voluminoze kërkimore. Materiali i rekomanduar për punë të mëtejshme ceket në kapitullin “Literatura shtesë” e cila është pjesë integrale e studimit.

Pas secilës pjesë, lexuesit i ofrohet një listë e kornizave zyrtare legjislative që lidhen me institucionet/instrumentet përkatëse, faqet zyrtare të internetit të këtyre institucioneve, por edhe udhëzime që mund të përdoren për kërkime të mëtejshme, siç janë dokumentet e programit, raportet vjetore, infografika, statistikat edhe shumë të tjera.

Për qëllime të studimit të mëtejshëm, në fund të secilës pjesë, janë parashtruar tri pyetje në lidhje me temën e përpunuar. Ato mund të shërbejnë si pikënisje për hartimin e një testi të shkurtër për praktikantë dhe studentë, ose si pika me interes për kolegët dhe miqtë që duan të mësojnë më shumë rreth politikës së BE-së në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, veçanërisht për ato që merren me luftën kundër krimit të organizuar.

Pa marrë parasysh se për çka vendosni, shpresojmë që kjo përmbledhje e shkurtër e instrumenteve të BE-së për luftën kundër krimit të organizuar të jetë e dobishme dhe të ju ndihmojë në përpjekjet tuaja profesionale, akademike ose private.

Faleminderit që na u bashkuat në këtë udhëtim të shkurtër nëpër instrumentet kryesore të BE-së për luftimin e krimit të organizuar!

Autori

Prioritetet e BE-së në luftën kundër krimit të organizuar

Prioritetet e BE-së në luftën kundër krimit të organizuar për periudhën 2018-2021

Bashkimi Evropian është përpjekur që nga viti 1999 për të krijuar një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë ndërsa qëllimet për arritjen e këtij prioriteti gjenden në Kapitullin V të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Kjo hapësirë, në të cilën sundojnë liria, siguria dhe drejtësia, u krijua për të siguruar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe për të ofruar për qytetarët nivel të lartë të mbrojtjes. Zgjidhjet politike në lidhje me këtë prioritet përfshijnë menaxhimin e kufijve të jashtëm të BE-së, bashkëpunimin e organeve gjyqësore në çështjet civile dhe penale, bashkëpunimin policor, azilin, politikën e imigracionit dhe luftën kundër krimit. Lufta kundër krimit është e përqendruar veçanërisht në parandalimin e terrorizmit, krimit të organizuar, krimit kompjuterik, shfrytëzimit seksual të fëmijëve, si dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe tregtimit të narkotikëve të ndaluar.

Në këtë drejtim, në vitin 2018, BE përgatiti dhe miratoi veprimet dhe hapat e nevojshëm për të luftuar kundër krimit të organizuar, i cili paraqet një kërcënim serioz për qytetarët, bizneset, ekonominë dhe shoqërinë evropiane në tërësi. Këto veprime dhe hapa ofrojnë një përgjigje adekuate ndaj situatës komplekse dhe kërcënimeve të ndryshme me të cilat përballet BE.

Vendimi Kornizë i Këshillit i datës 24 tetor 2008 për Luftën kundër Krimit të Organizuar (2008/841/JHA) e përkufizoi krimin e organizuar si "bashkim i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, në të cilin më shumë se dy persona veprojnë në bashkëpunim për të kryer vepra penale të dënueshme me burgim ose paraburgim për të paktën katër vjet, ose me një dënim më të rëndë për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore."

Bashkimi Evropian ka zhvilluar një kornizë strategjike dhe ligjore për të adresuar sfidat e paraqitura nga lufta kundër krimit të organizuar dhe ka formuar agjenci të specializuara për të forcuar bashkëpunimin midis organeve të zbatimit të ligjit, organeve të gjyqësorit dhe organeve të tjera kompetente të shteteve anëtare të BE-së¹.

Në mënyrë që të koordinojë masat që duhet të zbatohen në luftën kundër krimit të rëndë dhe të organizuar, Bashkimi Evropian miratoi në vitin 2018 një metodologji tjetër shumëvjeçare të quajtur "Cikli i Politikës". Cikli i politikës u miratua për një periudhë prej katër vjetësh, me qëllim të zgjidhjes dhe kthimit të kërcënimeve kriminale me të cilat përballet BE-ja në veprime operative. Cikli i parë katërvjeçar i politikës u zhvillua nga viti 2014 deri në vitin 2017, ndërsa në maj të vitit 2017, Këshilli i Bashkimit Evropian (COEU) miratoi konkluzione që përcaktojnë prioritetet në luftën kundër krimit të rëndë dhe të organizuar për periudhën 2018-2021.

¹ Shembujt, ndër të tjera, përfshijnë EUROJUST - Zyrën Evropiane për Bashkëpunim në Drejtësinë Penale, EUROPOL - Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit, si dhe CEPOL - Agjencinë e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Organeve të Zbatimit të Ligjit. Informata të mëtejshme mbi këto agjenci të BE-së janë në dispozicion në faqet 11-17.

Konkluzionet përcaktojnë dhjetë prioritete të BE-së në fushën e krimit të rëndë dhe të organizuar për atë periudhë. Ato janë:

1. krimi kompjuterik,
2. tregtimi me narkotikë,
3. trafikimi i qenieve njerëzore në BE,
4. vjedhje dhe thyerje të organizuara,
5. trafikimi i qenieve njerëzore brenda BE-së,
6. mashtrimet në lidhje me akcizën dhe TVSH-në,
7. tregtia e armëve,
8. krimi ekologjik,
9. pastrimi i parave; dhe
10. mashtrimet e bazuara në falsifikim të dokumenteve personale.

Këto kërcënime janë identifikuar si prioritete bazuar në të dhënat informative dhe janë rënë dakord në nivelin politik, ndërsa kërcënimet e reja monitorohen vazhdimisht në mënyrë që të formulohet një përgjigje adekuate e BE-së kur ato të paraqiten.

Si funksionon Cikli i Politikës së BE-së (EMPACT)

Cikli i Politikës përbëhet nga katër hapa kryesorë. Pasi EUROPOL prezanton një nga raportet e tij kryesore - Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Rëndë dhe i Organizuar (SOCTA)² - dhe rekomandimet për veprim bazuar në kërcënimet e identifikuara dhe të vlerësuara në këtë fushë, Ministrat e Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme (JHA) në Këshillin e Bashkimit Evropian përgatisin plane strategjike shumëvjeçare në mënyrë që të vendosin bazat për aktivitetet operative. Këto aktivitete zbatohen përmes planeve vjetore të veprimit operativ, në koordinim me shtetet anëtare dhe institucionet dhe agjencitë e BE-së. Këshilli i Bashkimit Evropian kryen vlerësim të rregullt të planeve për të monitoruar atë që është arritur, ndërsa Komisioni Evropian jep një vlerësim përfundimtar të pavarur në fund të ciklit.

Çfarë është EMPACT?

EMPACT është një mjedis *ad hoc* që shërben për të menaxhuar aktivitetet që synojnë arritjen e qëllimeve të përcaktuara në Ciklin e Politikës për Luftën kundër Krimit të Rëndë dhe të Organizuar.

Qëllimi i EMPACT është:

- të sigurojë bashkëpunim efektiv midis shteteve anëtare, organeve të zbatimit të ligjit, institucioneve, agjencive dhe organeve të BE-së dhe palëve të treta relevante;
- të trajtojë kërcënimet nga krimi i rëndë dhe i organizuar ndërkombëtar që përcaktohen të kanë prioritet.

PYETJE:

1. Sa fusha me prioritet përmendën në Ciklin e Politikës së BE-së për periudhën 2018-2020?
2. Nga sa hapa përbëhet Cikli i Politikës së BE-së?
3. Çka është EMPACT?

BURIMET NË INTERNET:

[Termet e referencës për ciklin e politikës së BE-së](#)

[Konkluzionet e Këshillit për përcaktimin e prioriteteve të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar dhe të rëndë ndërkombëtar për periudhën 2018 - 2021](#)

[Lufta e BE-së kundër krimit të organizuar - faqja zyrtare e Këshillit të BE-së](#)

[Infografikë - Lufta e BE-së kundër krimit të organizuar: 2018-2021](#)

[Cikli i politikës së BE-së - EMPACT - faqja zyrtare e EUROPOL-it](#)

[Rezultatet e EMPACT për vitin 2018](#)

Korniza institucionale e BE-së për luftën kundër korrupsionit

Komisioni Evropian: Drejtoria e Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme

Drejtoria e Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme (*DG HOME*) është një nga 33 drejtoritë e përgjithshme të Komisionit Evropian të organizuara në formën e departamenteve. Kjo Drejtori e Përgjithshme përgatit dhe monitoron zbatimin e rregullave dhe praktikave në mbarë Bashkimin Evropian me synim për të promovuar bashkëpunimin ndërkufitar në fushat e azilit, migracionit, kontrollit të kufirit, krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Qëllimi i Drejtorisë së Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme është një Evropë e hapur dhe më e sigurt në të cilën njerëzit jetojnë dhe punojnë në një mjedis të qëndrueshëm, ligjor dhe të sigurt dhe në të cilën garantohen të drejtat dhe siguria si e qytetarëve të saj ashtu edhe e shtetasve të vendeve që nuk janë anëtare të BE-së.

Cilat janë fushat kryesore të punës së kësaj Drejtorie të Përgjithshme?

Drejtoria e Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme vepron në katër fusha kryesore:

- **Miratimi i politikës** së përbashkët të BE-së për migracion dhe azil. Puna në këtë fushë ka për qëllim krijimin e një politike të balancuar dhe gjithëpërfshirëse të BE-së për migracion, në përputhje me [Strategjinë Evropë 2020](#). Aktivitetet i kushtohen miratimit të një game të gjerë rregullash në lidhje me migracionin legal brenda vetë BE-së, zgjidhjes së çështjeve të migracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe krijimit të Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit³.
- **Garantimi i sigurisë brenda BE-së**. Përmes luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, përmes promovimit të bashkëpunimit policor dhe përmes përgatitjes për reagim të shpejtë ndaj situatave të krizës, puna në këtë fushë ndihmon për të arritur një nivel më të lartë të sigurisë në Evropë. Veprimet e BE-së përfshijnë përdorimin e rregullave më të rrepta kundër tregtisë së paligjshme të armëve të zjarrit dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe rishikimin e ligjit për luftimin e abuzimit seksual të fëmijëve, shfrytëzimit seksual dhe pornografisë së fëmijëve.
- **Dimensioni i jashtëm dhe financimi i politikës së punëve të brendshme të BE-së**. Në këtë fushë, puna i kushtohet promovimit të dialogut me vendet që nuk janë anëtare të BE-së, bashkëpunimit me to dhe partneritetit në zgjidhjen e sfidave të përbashkëta. Qëllimi është të forcohet pozicioni i BE-së si një lojtar global i besueshëm, aktiv dhe pragmatik. Drejtoria e Përgjithshme menaxhon instrumentet financiare me të cilat i mbështet veprimet konkrete në fushën e punëve të brendshme.

³ Për më shumë informata mbi Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit, shih: https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/asylum_en, qasur më 7. 5. 2020.

- **Evropa për qytetarët.** Përmes pjesëmarrjes në këtë program, Drejtoria e Përgjithshme (*DG HOME*) kontribuon në atë që qytetarët të kuptojnë më mirë Bashkimin Evropian dhe krijojnë kushte më të mira për pjesëmarrje qytetare dhe demokratike në nivelin e BE-së.

Të gjitha këto fusha nënkuptojnë politika të caktuara në lidhje me:

- migrimin e ligjshëm dhe integrimin;
- migrimin e paligjshëm dhe kthimin e migrantëve;
- Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit;
- Shengenin, kufijtë dhe vizat;
- inovacionin dhe industrinë e cila merret me sigurinë;
- krimin e organizuar dhe trafikimin e qenieve njerëzore;
- krimin kompjuterik;
- situatat e krizës dhe terrorizmin;
- bashkëpunimin policor; dhe
- çështjet ndërkombëtare.

Si është e organizuar dhe si menaxhohet DG HOME?

Të gjitha Drejtoritë e Përgjithshme, përfshirë ato për Migracion dhe Punë të Brendshme, drejtohen nga Drejtore të Përgjithshme të cilët i japin llogari Komisionerit kompetent të Komisionit Evropian, i cili emërohet për një periudhë pesë vjeçare. *DG HOME* përbëhet nga gjashtë drejtori përgjegjëse për tema konkrete që përfaqësojnë fushëveprimin e tyre të punës. Ato janë: Drejtoria për Strategji dhe Çështje të Përgjithshme; Drejtoria për Kufij, Ndërveprim dhe Inovacion; Drejtoria për Migracion, Mbrojtje dhe Viza; Drejtoria e Zbatimit të Ligjit dhe Sigurisë; Drejtoria për Fondet/Burimet Financiare për Nevojat e Migracionit dhe Sigurisë; dhe Drejtoria për Auditimin Financiar, Menaxhimin e të Dhënave dhe Vlerësimin e Riskut.

Grafikun organizativ të Drejtorisë së Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme mund të shikoni [KËTU](#).

Për më tepër, BE ka formuar agjenci të decentralizuara në fushën e punëve të brendshme për të ndihmuar shtetet anëtare dhe qytetarët e tyre me detyra të caktuara dhe t'u sigurojë atyre informata dhe këshilla. Këto agjenci - Agjencia Evropiane për Kontrollin e Kufijve dhe Roje Bregdetare (*FRONTEx*); Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (*EUROPOL*); Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Organeve të Zbatimit të Ligjit (*CEPOL*); Qendra Monitoruese Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave (*EMCDDA*); dhe Agjencia Evropiane për Sisteme të Mëdha Informative, përkatësisht *eu-LISA* – zbaton edhe aktivitetet në lidhje me përgatitjen dhe marrjen e vendimeve, monitorimin e operacioneve dhe ofrimin e mbështetjes për krijimin e politikave.

Nën patronazhin e *DG HOME* veprojnë disa rrjete, anëtarët e të cilëve kanë mundësi të shkëmbejnë mendime dhe informata për politika të caktuara në lidhje me punët e brendshme. Këto janë p.sh. [Forumi i Shoqërisë Civile për Drogat](#), [Forumi Evropian i](#)

[Migracionit](#), [Rrjeti Evropian i Migracionit](#), [Rrjeti i ndërgjegjësimit për radikalizimin](#) dhe [Rrjeti i paralajmërimit për infrastrukturën kritike](#). Anëtarët e rrjetit vijnë nga pjesëtarët e organeve kombëtare të administratës deri te përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe individëve.

Buxheti i destinuar për punët e brendshme për periudhën 2014-2020 kap shumën prej 10,52 miliardë euro. Pjesa më e madhe e këtyre fondeve, respektivisht 6,9 miliardë euro, përdoren për të financuar aktivitetet e Fondit për Azil, Migracion dhe Integrim dhe Fondit të Sigurisë së Brendshme, nga të cilat financohen veprime në lidhje me politikën e punëve të brendshme të BE-së. Pjesa tjetër e fondeve, në vlerë prej 2,36 miliardë euro, është e rezervuar për financimin e punës së agjencive përgjegjëse për punët e brendshme.

DG HOME dhe Ballkani Perëndimor

GD HOME në Ballkanin Perëndimor (WB6) kryen disa detyra dhe aktivitete të rëndësishme. Këto përfshijnë: menaxhimin e marrëveshjeve për lehtësimin e vizave; lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet WB6 dhe Agjencisë Evropiane për Kontrollin e Kufijve dhe Roje Bregdetare (FRONTEx) në lidhje me menaxhimin e kufijve; menaxhimin efektiv të kufijve; migracionet e paligjshme dhe luftën kundër trafikimit të migrantëve; aktivitete kundër terrorizmit të tilla si mbështetja e rrjetit të ekspertëve për siguri/luftë kundër terrorizmit në delegacionet e BE-së dhe bashkëpunimi operativ përmes agjencive të tilla si Agjencia Evropiane për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (EUROPOL), Agjencia Evropiane për Trajnim të Organeve për Zbatimin e Ligjit (CEPOL); dhe Zyra Evropiane për Bashkëpunim në Drejtësi Penale (EUROJUST).

PYETJE:

1. Cili është fushëveprimi i punës së Drejtorisë së Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme?
2. Përmendni të paktën pesë instrumente për të cilat është përgjegjëse Drejtoria e Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme.
3. Cilat dy fonde financojnë veprimet në lidhje me politikën e punëve të brendshme të BE-së?

BURIMET NË INTERNET:

[Faqja zyrtare e internetit e Drejtorisë së Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme](#)

[Agjenda Evropiane për Migracion](#)

[Agjenda Evropiane për Siguri](#)

[Sigurimi i kufijve të BE-së](#)

[Jlva Johanson, Komisioner për Punë të Brendshme](#)

[Llogaria zyrtare në Twitter e Drejtorisë së Përgjithshme për Migracion dhe Punë të Brendshme](#)

Komiteti i Parlamentit Evropian për Liri Civile, Drejtësi dhe Punë të Brendshme (LIBE)

Komiteti për Liri Civile, Drejtësi dhe Punë të Brendshme (*LIBE*) është një nga 20 komitetet e përhershme të Parlamentit Evropian. Komitetet janë të autorizuar të ndikojnë në projektligje duke përgatitur dhe miratuar raporte, duke propozuar ndryshime në akte të ndryshme të diskutuara në seancat plenare të Parlamentit Evropian dhe duke caktuar anëtarët e ekipit përgjegjës për negociimin e akteve përkatëse me Këshillin e Bashkimit Evropian. Për më tepër, këto komitete kanë të drejtë të miratojnë raporte me iniciativën e tyre, të organizojnë dëgjime me ekspertë për tema specifike dhe të analizojnë punën e organeve dhe institucioneve të tjera të BE-së.

Komiteti *LIBE* është përgjegjës për legjislacionin dhe mbikëqyrjen demokratike të politikave që i mundësojnë Bashkimit Evropian për të formuar, përmirësuar dhe forcuar fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Cilat janë aktivitetet kryesore të komitetit LIBE?

Aktivitetet dhe detyrat specifike të komitetit *LIBE*, të cilat përcaktohen në Rregulloren e Punës të Parlamentit Evropian, përfshijnë:

- sigurimin e respektimit të plotë të Kartës së të Drejtave Themelore në territorin e BE-së;
- zhvillimin e mëtejshëm të hapësirës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, me theks të veçantë në masat që lidhen me:
 - hyrjen dhe lëvizjen e personave, azilin dhe migracionin;
 - menaxhimin e integruar të kufijve të përbashkët;
 - bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale, përfshirë terrorizmin; dhe
 - zhvillimin e një qasje më të harmonizuar të BE-së ndaj të drejtës penale;
- përgjegjësinë për agjencitë e decentralizuara të BE-së në fushën e punëve të brendshme (*EMCDDA*, *EUROPOL*, *EUROJUST* dhe *CEPOL*), Agjencinë e të Drejtave Themelore, Prokurorinë Publike Evropiane, si dhe organe dhe agjenci të tjera në të njëjtën fushë.

Si funksionon LIBE?

Komiteti *LIBE* ka 68 anëtarë të rregullt dhe 66 anëtarë rezervë (të cilët zëvendësojnë ata të rregullt), të cilët zgjedhin një kryesues dhe tre nënkryetarë në mesin e tyre.

Listën e të gjithë anëtarëve të komitetit mund ta shihni [KËTU](#).

Komiteti vepron përmes ndërveprimit të përditshëm me Komisionin Evropian, Këshillin e Bashkimit Evropian dhe në bashkëpunim të ngushtë me parlamentet kombëtare. Komunikimi i tij me përfaqësuesit e gjyqësorit dhe agjencitë e zbatimit të ligjit është gjithashtu i rregullt, si dhe me *Ejustice*, me agjencitë që merren me punët e brendshme, me anëtarët e komunitetit akademik dhe me atë të shoqërisë civile.

Tërë dokumentacioni nga mbledhjet, procesverbalet dhe historiku i votimit, si dhe të gjitha 'transmetimet' dhe videot xhirimet, janë në dispozicion në faqen zyrtare të komitetit LIBE. Faqja, përveç kësaj, ofron një bibliotekë të dokumenteve të Komitetit, dhe ngjarje të ndryshme të tilla si dëgjime, punëtori dhe takime me përfaqësues të parlamenteve kombëtare.

Pasi që anëtarët e komitetit *LIBE* në të njëjtën kohë janë edhe anëtarë të Parlamentit Evropian, respektivisht zgjidhen nga qytetarët në shtetet anëtare të BE-së drejtpërdrejt, komiteti synon të vendos dialog të frytshëm me të gjithë aktorët, dhe veçanërisht me qytetarët.

LIBE dhe Ballkani Perëndimor

Kur bëhet fjalë për Ballkanin Perëndimor (*WB6*), përveç pjesëmarrjes aktive në aktivitetet e Parlamentit Evropian në lidhje me politikën e zgjerimit, anëtarët e komitetit *LIBE* paraqesin në Këshillin e Bashkimit Evropian ndryshime dhe plotësime, rekomandime dhe raporte në lidhje me marrëveshjet e lidhura midis BE-së dhe pjesëtarëve të *WB6* dhe aktivitetet e kryera nga agjencitë përgjegjëse për punët e brendshme (p.sh. *FRONTEX*, *EUROJUST*). Komiteti me kujdes monitoron progresin e *WB6* në çështjet që bien brenda fushëveprimit të punës së tij.

PYETJE:

1. Cilat janë detyrat dhe aktivitetet kryesore të Komiteteve të Parlamentit Evropian, përfshirë edhe të Komitetit *LIBE*?
2. Cilat janë masat që komiteti *LIBE* i ndërmerr në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë?
3. Cilit grup politik në Parlamentin Evropian i takon kryesuesi i komitetit *LIBE*?

BURIMET NË INTERNET:

[Faqja zyrtare e komitetit LIBE](#)

[Rregullorja e Punës e Parlamentit Evropian](#)

[Faqja zyrtare e Parlamentit Evropian](#)

Komiteti i Përhershëm për Siguri të Brendshme (COSI)

Komiteti i Përhershëm për Siguri të Brendshme (COSI), i cili është themeluar nga neni 71. i Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nga një vendim i veçantë i Këshillit të Bashkimit Evropian nga viti 2010, është një nga organet përgatitore të atij Këshilli. Qëllimi i COSI është të lehtësojë, promovojë dhe forcojë koordinimin e bashkëpunimit midis shteteve anëtare të BE-së në fushën e sigurisë së brendshme. Koncepti i sigurisë së brendshme përfshin trajtimin e kërcënimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën, sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve (nga parandalimi i krimit deri te fatkeqësitë natyrore dhe atyre të shkaktuara nga veprimi i njeriut, të tilla si zjarret në pyje, tërmetet, përmbytjet dhe stuhitë), në të cilat bashkëpunimi midis policisë dhe organeve kufitare, gjyqësorit dhe shërbimeve të tjera (nga sektori i shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe civile) është i një rëndësie thelbësore.

Cilat janë aktivitetet kryesore të Komitetit COSI?

Për të arritur qëllimin e mësipërm, aktivitetet e Komitetit COSI synojnë:

- sigurimin e bashkëpunimit efektiv operativ për çështjet e sigurisë së brendshme të BE-së, përfshirë fushat e mbuluara nga bashkëpunimi midis policisë dhe shërbimeve doganore, kontrollin e kufijve dhe bashkëpunimin e organeve gjyqësore në çështjet penale;
- kryerjen e vlerësimit të drejtimit të përgjithshëm dhe efikasitetit të bashkëpunimit operativ; dhe
- ofrimin e ndihmës Këshillit të BE-së gjatë reagimit ndaj sulmeve terroriste, fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të shkaktuara nga veprimi i njeriut, në përputhje me ["Klauzolën e solidaritetit"](#) të përfshirë në nenin 222 të Traktatit për Funkzionimin e BE-së.

Këshilli i Bashkimit Evropian për Drejtësi dhe Punë të Brendshme

Këshilli për Drejtësi dhe Punë të Brendshme është një nga 10 strukturat e Këshillit të Bashkimit Evropian, dhe përbëhet nga Ministrat e Drejtësisë dhe/ose të Brendshëm të shteteve anëtare të BE-së. Këshilli zakonisht mblidhet çdo tre muaj dhe është i përkushtuar për zhvillimin e bashkëpunimit dhe politikës së përbashkët për çështje të ndryshme ndërkufitare kushtuar bërjes së të gjithë territorit të BE-së në një hapësirë ku sundon liria, siguria dhe drejtësia.

Këshilli është përgjegjës për bashkëpunimin e organeve të drejtësisë në fushat e çështjeve civile dhe penale, për politikën e azilit dhe imigracionit, mbrojtjen civile dhe luftën kundër krimit të rëndë dhe të organizuar dhe terrorizmit. Këshilli trajton gjithashtu tema që lidhen me zonën Shengen. Ministrat e Drejtësisë janë përgjegjës për bashkëpunimin e organeve të drejtësisë në fushat e çështjeve civile/penale dhe të drejtave themelore, ndërsa Ministrat e Brendshëm merren me, ndër të tjera, migracionin, menaxhimin e kufijve dhe bashkëpunimin policor.

Së bashku me Parlamentin Evropian, Këshilli miraton akte që synojnë sigurimin e të drejtave themelore, lëvizjen e lirë të njerëzve në të gjithë Bashkimin Evropian dhe sigurimin e qytetarëve me një nivel të lartë të mbrojtjes.

Si funksionon COSI?

Anëtarët e *COSI* vijnë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, nga Ministritë e Drejtësisë ose të Brendshme, dhe aty janë gjithashtu edhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian dhe Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (*EEAS*) së bashku me përfaqësuesit e organeve dhe institucioneve të tjera kompetente. Në takime të *COSI* mund të marrin pjesë si vëzhgues edhe përfaqësues të agjencive të BE-së siç janë *EUROPOL*, *EUROJUST*, *FRONTEX* dhe *CEPOL*.

COSI nuk merr pjesë në përgatitjen e akteve ligjore dhe as nuk ka mandat për të udhëhequr operacione. Këto janë detyrime të shteteve anëtare të BE-së.

COSI i raporton Këshillit të Bashkimit Evropian mbi aktivitetet e kryera, të cilat më pas i përcillen Parlamentit Evropian dhe parlamenteve kombëtare.

COSI dhe Ballkani Perëndimor

Puna e *COSI* në çështjet që lidhen me Ballkanin Perëndimor (*WB6*) ka të bëjë me punën e Komitetit për Politikë dhe Siguri, një organi tjetër përgatitor të Këshillit të BE-së. Të dy komitetet punojnë së bashku për të forcuar lidhjet midis sigurisë së brendshme dhe të jashtme të BE-së (që përfshin zhvillimin e strategjive dhe politikave, por edhe aktivitetet e BE-së në politikat e jashtme dhe të sigurisë që promovojnë paqen dhe stabilitetin dhe bashkëpunimin me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare gjatë tejkalimit të kërcënimeve dhe sfidave të përbashkëta). Qëllimi i aktiviteteve të këtyre dy organeve është zhvillimi dhe avancimi i bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe luftës kundër krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor. Ato gjithashtu ndihmojnë iniciativat ekzistuese rajonale në zgjidhjen e sfidave të përbashkëta të sigurisë dhe sundimit të ligjit.

PYETJE:

1. Komiteti i Përhershëm për Siguri të Brendshme (*COSI*) është organi përgatitor i cilit institucion të BE-së?
2. Kush janë anëtarët e Komitetit *COSI*?
3. A merr pjesë *COSI* në procedurën legjislativë të BE-së?

BURIMET NË INTERNET:

[Faqja zyrtare e internetit e COSI](#)

[Vendim i Këshillit i 25 shkurt 2010 për themelimin e Bordit të COSI](#)

[Raporti në Parlamentin Evropian dhe parlamentet kombëtare mbi veprimet e COSI për periudhën nga korriku 2017 deri në dhjetor 2018](#)

[Faqja zyrtare e internetit e Këshillit të Bashkimit Evropian](#)

Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (EUROPOL)

Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (*EUROPOL*) mbështet shtetet anëtare në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit ndërkombëtar dhe të organizuar, krimit kompjuterik dhe terrorizmit. *EUROPOL* vepron si qendra kryesore e informacionit, dhe ofron mbështetje operative dhe zgjidhje në nivelin e Evropës. *EUROPOL* synon të sigurojë një përgjigje efektive të Bashkimit Evropian ndaj terrorizmit, trafikut të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore, krimit kompjuterik dhe aktiviteteve të tjera që bien në grupin e krimit të organizuar. Këto, aktivitete të tjera, përfshijnë:

- tregtinë e armëve;
- abuzimin seksual të fëmijëve;
- pastrimin e parave;
- hetimet financiare:
- korrupsionin;
- falsifikimin; dhe
- konfiskimin dhe rikthimin e pasurisë.

EUROPOL u krijua në bazë të Konventës së nënshkruar nga shtetet anëtare të BE-së në vitin 1995 dhe është në fuqi që nga viti 1999. Në vitin 2010, u bë një agjenci që e bazon punën e vet në vlerat kryesore për të cilat angazhohet: shërbimi ndaj shoqërisë, integriteti, përgjegjësia, iniciativa, partneriteti dhe diversiteti.

EUROPOL ka më shumë se 1.000 punonjës, 220 zyrtarë ndërlidhës dhe rreth 100 persona që punojnë në analizën e veprimtarisë kriminale. Selia e EUROPOL-it është në Hagë, në Holandë.

Cilat janë prioritetet kryesore të EUROPOL-it?

Strategjia e *EUROPOL*-it përfaqëson kornizë referuese për operacionet e tij të përditshme dhe mbështetjen që ofron për bashkëpunimin në zbatimin e ligjit në Bashkimin Evropian.

Prioritetet udhëheqëse strategjike të *EUROPOL*-it janë:

- të jetë Qendra Evropiane e Informacionit për Krimin që përdor më së miri informacionin që merr nga partnerët e saj të shumtë;
- të sigurojë mbështetje të shpejtë operative;
- të shërbejë si platformë për zgjidhjet evropiane kur bëhet fjalë për punën policore;
- të drejtojë kërkimin dhe inovacionin që synon fushat e zbatimit të ligjit; dhe
- të shërbejë si shembull i organizatës së përgjegjshme evropiane të zbatimit të ligjit që punon mirë, menaxhohet mirë dhe që promovon diversitetin dhe angazhimin e punonjësve.

Qëllimet strategjike janë cekur dhe përshkruar më hollësisht në [dokumentin programor shumëvjeçar të EUROPOL-it](#) (botimi i vlefshëm i të cilit i referohet periudhës 2020-2021).

Cilat janë shërbimet kryesore dhe llojet e mbështetjes që ofron EUROPOL?

EUROPOL-i u ofron agjencive kombëtare të zbatimit të ligjit një sërë mjetesh dhe metodash për të luftuar kundër krimit: lehtëson shkëmbimin e informacionit, kryen analizën e veprave penale dhe vlerësimin e kërcënimeve, dhe ndihmon në koordinimin e hetimeve dhe veprimtarive operative ndërkufitare.

Për dallim nga forcat e policisë kombëtare, EUROPOL nuk ka autoritetin për të kryer hetime në mënyrë të pavarur.

EUROPOL ka tri platforma kryesore dhe baza të të dhënave që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit dhe ndihmojnë vendimmarrësit në shtetet anëtare për të përcaktuar prioritetet në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Ato janë: [Aplikacioni i Rrjetit për Shkëmbim të Sigurt të të Dhënave \(SIENA\)](#), [Sistemi Informativ i Europol-it \(EIS\)](#) dhe [Platforma e Europol-it për Ekspertë \(EPE\)](#).

EUROPOL, shtetet anëtare të BE-së dhe palët e treta shkëmbejnë të dhëna për aktivitetet kriminale përmes Qendrës Operative, e cila operon 24 orë në ditë. Kjo njësi me siguri shumë të lartë punëson më shumë se 30 ekspertë dhe analistë. Përveç shërbimeve të tyre, EUROPOL ofron mbështetje mjeko-ligjore për agjencitë e zbatimit të ligjit në të gjithë BE-në dhe i ndihmon ato në ndërtimin e kapaciteteve dhe mbajtjen e trajnimit.

EUROPOL ka avancuar aftësitë e veta dhe ka krijuar në kohët e fundit disa qendra që adresojnë posaçërisht kërcënimet specifike me të cilat përballet BE:

- Qendra Evropiane për Krimin Kompjuterik (EC3), e themeluar në vitin 2013;
- Qendra Evropiane për Luftimin e Trafikimit të Migrantëve (EMSC), e themeluar në vitin 2016;
- Qendra Evropiane për Luftimin e Terrorizmit (ECTC), e themeluar në vitin 2016;
- Koalicioni i Koordinuar për Luftimin e Shkeljes së Pronës Intelektuale (IPC3).

Si menaxhohet EUROPOL-i?

Si të gjitha agjencitë e tjera të BE-së, EUROPOL-i menaxhohet në bazë të sistemit të kontrollit, inspektimit dhe mbikëqyrjes. Bordi Drejtues është organi kryesor drejtues që ofron udhëzime strategjike dhe mbikëqyrë zbatimin e detyrave. Miraton programet vjetore dhe shumëvjeçare të punës dhe buxhetet vjetore, dhe kryen detyra menaxhuese. Anëtarësia e Bordit Drejtues përfshinë një përfaqësues nga secili prej shteteve anëtare të mbuluara nga Rregullorja për themelimin e EUROPOL-it dhe një përfaqësues të Komisionit Evropian. Danimarka ka statusin e vëzhguesit.

Në krye të EUROPOL-it është Drejtori Ekzekutiv i cili, pas vendimit të bordit drejtues, emërohet me vendim unanim të Këshillit të BE-së për Drejtësi dhe Punë të Brendshme për një periudhë katër vjeçare. Drejtori Ekzekutiv ndihmohet nga tre zëvendës. Ata emërohen nga i njëjti këshill dhe mandati i tyre zgjat për katër vjet.

Këshilli i BE-së për Drejtësi dhe Punë të Brendshme është përgjegjës për kontrollimin dhe drejtimin e punës së *EUROPOL*-it. Ai, së bashku me Parlamentin Evropian, miraton buxhetin e tij dhe miraton rregullore në lidhje me punën e tij. Parlamenti Evropian luan një rol të rëndësishëm në monitorimin e punës së *EUROPOL*-it. Mbikëqyrja politike e punës së tij është përgjegjësi e Grupit të Përbashkët Parlamentar për Mbikëqyrje (*JPSG*) të përbërë nga anëtarë të parlamenteve kombëtare (më së shumti nga katër anëtarë nga secili parlament veç e veç) dhe anëtarë të Parlamentit Evropian (deri në 16).

Puna e *EUROPOL*-it mbikëqyret nga Komiteti i Përhershëm për Siguri të Brendshme (*COSI*), ndërsa Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (*EDPS*) garanton që të dhënat në posedim të *EUROPOL*-it të ruhen, përpunohen dhe përdoren në mënyrë që i mbron të gjitha të drejtat e individëve. Lidhur me mbikëqyrjen financiare, raportet vjetore të *EUROPOL*-it janë subjekt i auditimit të jashtëm nga Gjykata Evropiane e Auditorëve (*ECA*).

EUROPOL-i dhe Ballkani Perëndimor

Ballkani Perëndimor është një zonë me rëndësi të veçantë për *EUROPOL*-in. Bashkëpunimi me rajonin është konsideruar si prioritet për vite me radhë, duke rezultuar me lidhjen e marrëveshjeve strategjike dhe operative me gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor. Me zbatimin e marrëveshjeve të mësipërme dhe zbatimin e plotë të mekanizmave tashmë ekzistues, trafikimi i migrantëve, krimi i organizuar dhe terrorizmi mbeten fushat kryesore me interes të përbashkët. Në letrën e Komisionit Evropian të vitit 2018 "[Një perspektivë e besueshme e zgjerimit dhe angazhimit të shtuar të BE-së në Ballkanin Perëndimor](#)" është propozuar angazhim më i madh i *EUROPOL*-it në rajonin e *WB6* në lidhje me çështjet e sigurisë dhe migracionit. Letra parashikon gjithashtu hapjen e tri zyrave ndërlidhëse me *EUROPOL*-in në Ballkanin Perëndimor (e para u hap në Shqipëri në shtator 2019, ndërsa dy të tjerat janë planifikuar të jenë në Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi), si dhe promovimin e mëtejshëm të ekipeve të përbashkëta të hetimit.

PYETJE:

1. Ku gjendet selia e *EUROPOL*-it?
2. Cilat janë aktivitetet kryesore që *EUROPOL*-i i zbaton dhe shërbimet që i ofron?
3. Kush e emëron Drejtorin Ekzekutiv të *EUROPOL*-it?

BURIMET NË INTERNET

[Rregullorja për themelimin e *EUROPOL*-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e *EUROPOL*-it](#)

[Historia interaktive e *EUROPOL*-it](#)

[Strategjia e *EUROPOL*-it 2020+](#)

[Statistikat dhe të dhënat e *EUROPOL*-it](#)

[EUROPOL-i në veprim](#)

[Raportet kryesore të *EUROPOL*-it](#)

Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Drejtësi Penale (EUROJUST)

Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Drejtësi Penale (*EUROJUST*) siguron mbështetje në koordinimin dhe bashkëpunimin e organeve kombëtare gjyqësore në luftën kundër atyre llojeve të terrorizmit dhe krimin të organizuar që nuk prekin vetëm një shtet anëtar.

EUROJUST vepron me kërkesë të organeve kompetente të shtetit anëtar ose me iniciativën e vet. Në disa raste, ajo gjithashtu mund të veprojë me kërkesë të Komisionit Evropian ose Zyrës së Prokurorit Publik Evropian (*EPPO*).

Idea e krijimit të një njësie të bashkëpunimit gjyqësor u prezantua për herë të parë në një takim të Këshillit të Evropës në tetor 1999. Vendimi i Këshillit u miratua dhe *EUROJUST* u themelua në vitin 2002. Në ndërkohë, ajo është rritur – sikurse edhe detyrat dhe aktivitetet e saj operative në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në Evropë. Në 2018, Këshilli i BE-së dhe Parlamenti Evropian miratuan një rregullore të re e cila avancoi punën e saj. Selia qendrore e *EUROJUST* është në Hagë, në Holandë.

Misioni dhe aktivitetet e EUROJUST

Misioni i *EUROJUST* është zhvillimi dhe avancimi i bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e drejtësisë, si dhe besimi i ndërsjellë në luftën e Bashkimit Evropian kundër krimin të organizuar ndërkufitar.

Detyrat kryesore të *EUROJUST* janë:

- të informojë organet kompetente të Shteteve Anëtare për hetimet dhe ndjekjet penale;
- të ndihmojë organet kompetente të Shteteve Anëtare në sigurimin e koordinimit sa më të mirë të mundshëm të hetimeve dhe ndjekjeve penale;
- që, bazuar në analizat e *EUROPOL*-it, të ndihmojë në avancimin e bashkëpunimit midis organeve kompetente të shteteve anëtare;
- që, në çështjet penale, të bashkëpunojë dhe të konsultohet me Rrjetin Gjyqësor Evropian (*EJN*);
- të bashkëpunojë ngushtë me Zyrën e Prokurorit Publik Evropian për çështje brenda kompetencës së vet;
- të sigurojë mbështetje operative, teknike dhe financiare për operacionet ndërkufitare dhe hetimet e kryera nga shtetet anëtare;
- të ofrojë mbështetje dhe herë pas here të marrë pjesë në qendra të specializuara profesionale të *EUROPOL*-it si dhe në institucione, organe, zyra dhe agjenci të tjera të Bashkimit Evropian;
- të bashkëpunojë me institucionet, organet, zyrat, agjencitë dhe rrjetet e BE-së që punojnë në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë; dhe
- të mbështet veprimin e shteteve anëtare në luftën kundër krimin të rëndë.

Në mënyrë që të jetë në gjendje të kryejë detyrat e veta në mënyrë efikase, *EUROJUST* ka të drejtë të kërkojë nga organet kompetente të shteteve anëtare për të hetuar akte të caktuara dhe për t'i ndjekur penalisht, ose për të vepruar si një koordinator për ato organe kompetente. Përveç kësaj, ajo ka të drejtë të krijojë një ekip të përbashkët hetimor dhe t'i sigurojë atij informacionin që i nevojitet për të kryer detyrat e tij, si dhe të marrë masa të posaçme hetimore ose ndonjë masë tjetër të justifikuar për qëllimet e hetimit ose ndjekjes penale.

Cilat janë shërbimet kryesore dhe llojet e mbështetjes që i ofron EUROJUST?

EUROJUST në të gjitha rastet, siguron koordinimin e hetimeve, përmes angazhimit për shkëmbimin e informacionit dhe zbulimin e marrëdhënieve të ndërlidhura midis hetimeve që në momentin e caktuar janë në vazhdim. Përveç kësaj, ndihmon në zhvillimin e strategjive prokuroriale dhe zbatimin e veprimeve të përbashkëta.

Me kalimin e viteve, numri i rasteve po rritet vazhdimisht. EUROJUST në vitin 2018 kishte 6.500 raste, ndërsa në vitin 2018 ka koordinuar gati 200 hetime ndërkufitare në lidhje me terrorizmin. Në të njëjtin vit, u krijua Regjistri Gjyqësor Evropian për Luftën kundër Terrorizmit.

EUROJUST është nikoqire e Rrjetit Gjyqësor Evropian për Krim Kompjuterik (*EJCN*). Ajo gjithashtu ofron mbështetje për mbrojtjen e kufijve evropianë duke punuar në hetime në fushën e trafikimit të migrantëve, që kërkon bashkëpunim efektiv gjyqësor si midis shteteve anëtare ashtu edhe me vendet e origjinës, transitit dhe destinacionit jashtë Evropës.

Duke pasur parasysh pozicionin unik kur bëhet fjalë për koordinimin e hetimeve penale ndërkufitare, *EUROJUST* mbështet përdorimin e plotë të mjeteve të BE-së për bashkëpunim gjyqësor bazuar në njohjen reciproke, të tilla si urdhër arresti evropian⁴ dhe urdhri evropian për inicimin e hetimit⁵.

EUROJUST, në vitin 2018, ka mbështetur lëshimin e pothuajse 1.000 urdhrave për inicimin e hetimit dhe zbatimin e më shumë se 700 urdhër-arresteve evropiane.

Si menaxhohet EUROJUST?

Kolegjiumi i *EUROJUST* përbëhet nga anëtarë kombëtarë, një nga secili shtet anëtar i BE-së (me përjashtim të Danimarkës, për të cilën Rregullorja për themelimin e *EUROJUST* nuk është e detyrueshme), dhe përfshin gjyqtarë, prokurorë ose persona të tjerë po aq profesionistë në fushën e drejtësisë, një përfaqësues të Komisionit Evropian dhe një drejtor administrativ që nuk ka të drejtë vote. Kolegjiumi zgjedh Kryetarin e *EUROJUST* për një periudhë katër vjeçare, me një kufizim prej dy mandatesh radhazi. Kryetari mbikëqyr punën e Kolegjiumit dhe ndihmohet në detyrat e tij nga dy nënkryetarë. Bordi Ekzekutiv ka gjashtë anëtarë; ai ndihmon në menaxhimin e kolegjiumit por nuk është i përfshirë në aktivitetet e tij operative. Drejtori Administrativ e udhëheq administratën dhe është përfaqësues ligjor i *EUROJUST*.

4 Për më shumë informacion mbi Urdhër Arrestin Evropian, shihni f. 32

5 Për më shumë informacion mbi Urdhrin Evropian të Hetimit, shihni f. 33

Parlamenti Evropian dhe parlamentet e shteteve anëtare luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e transparencës dhe kontrollit demokratik të punës së kësaj organizate. Sa i përket Këshillit të BE-së, *EUROJUST* merr pjesë në punën e organeve të tij përgatitore përkatëse duke kontribuar në procesin e vendimmarrjes. Gjatë kryerjes së misionit dhe detyrave të veta, *EUROJUST* punon ngushtë me institucionet, agjencitë dhe organet e tjera të BE-së.

EUROJUST dhe Ballkani Perëndimor

EUROJUST ka ndihmuar në pothuajse 200 hetime penale të kryera bashkërisht nga shtetet anëtare të BE-së dhe *WB6*, dhe ka krijuar një kornizë për bashkëpunimin strukturor të organeve gjyqësore në rajon. Shqipëria, Maqedonia Veriore, Mali i Zi dhe Serbia kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me *EUROJUST* dhe kanë emëruar 'prokurorët ndërlidhës' që punojnë në selinë qendrore të *EUROJUST*. *EUROJUST* ka persona kontakti në Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali të Zi dhe Serbi. Që nga janari 2015, janë regjistruar 330 raste në të cilat morën pjesë 14 ekipe të përbashkëta hetimore (*JIT*).

PYETJE:

1. Me çfarë detyra është i ngarkuar *EUROJUST*?
2. Sa anëtarë kombëtarë i ka kolegji i *EUROJUST*?
3. Kush në Ballkanin Perëndimor ka emëruar prokuror ndërlidhës që punon në selinë qendrore të *EUROJUST*?

BURIMET NË INTERNET:

[Rregullorja për themelimin e *EUROJUST*-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e *EUROJUST*-it](#)

[Regjistri publik i *EUROJUST*-it](#)

[Raporti vjetor i *EUROJUST*-it për vitin 2018](#)

[Strategjia shumëvjeçare e *EUROJUST*-it për periudhën 2019-2021](#)

[Struktura organizative e *EUROJUST*-it](#)

Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Organeve për Zbatimin e Ligjit (CEPOL)

Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Organeve për Zbatimin e Ligjit (CEPOL) zhvillon, zbaton dhe organizon trajnime për policinë dhe personelin tjetër të zbatimit të ligjit. Kontribuon për një Evropë më të sigurt duke lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive ndërmjet zyrtarëve të policisë në shtetet anëtare të BE-së dhe disa vende jo-anëtare të BE-së, të gjitha për çështje që janë, në veçanti, të përcaktuara si prioritete të sigurisë në Ciklin e Politikës së BE-së për Krimin e Organizuar. CEPOL u krijua në vitin 2005, me një vendim të Këshillit i cili u ndryshua nga Rregullorja për Themelimin e CEPOL e cila u miratua në vitin 2015 nga Këshilli i BE-së dhe Parlamenti Evropian. Rregullorja nuk është detyruese për Danimarkën. Selia qendrore e CEPOL gjendet në Budapest (Hungari), ndërsa zyra e ndërlidhjes gjendet në Bruksel (Belgjikë).

Cilat janë prioritetet kryesore të CEPOL?

CEPOL ofron trajnim inovativ dhe të avancuar dhe promovon bashkëpunimin midis organeve policore përmes një rrjeti institucionesh arsimore që merren me trajnimin policor në shtetet anëtare të BE-së. Përveç kësaj, i ndihmon këto institucione rreth trajnimit *front-line* në temën mbi prioritetet e sigurisë, bashkëpunimin për zbatimin e ligjit dhe shkëmbimin e informacionit. CEPOL u siguron zyrtarëve të policisë mundësinë të zhvillohen personalisht dhe profesionalisht përmes trajnimit, dhe kështu të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve të sigurisë në Evropë.

Qëllimet kryesore të CEPOL janë:

- të mbështesë, zhvillojë, zbatojë dhe koordinojë trajnimin për zyrtarët e policisë;
- të japë grante për institucionet arsimore kombëtare për zbatimin e programeve të trajnimit;
- të bashkëpunojë me vendet jo-anëtare të BE-së brenda kornizës së rregullimeve të punës;
- të trajnojë udhëheqësit, udhëheqësit dhe trajnerët e ardhshëm; dhe
- të integrojë rezultatet e kërkimit në trajnimin e vet.

Cilat janë shërbimet kryesore që i ofron CEPOL?

Shërbime që i ofron CEPOL përfshijnë:

- trajnimin rezident (kurse, konferenca dhe seminare);
- të mësuarit në *internet* (uebinare, module në *internet*, kurse në *internet*);
- programe shkëmbimi;
- programin e përbashkët master të CEPOL; dhe
- trajnim në nivelin e BE-së, në përputhje me Vlerësimin Strategjik të Nevojave të Trajnimit në Bashkimin Evropian.

Si menaxhohet CEPOL?

Në mënyrë që të sigurohet një përgjigje kolektive ndaj kërcënimeve më serioze të sigurisë, CEPOL bashkëpunon me organe të ndryshme të BE-së, organizata ndërkombëtare, por edhe me vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian.

CEPOL udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv, i cili është përgjegjës para Bordit Drejtues të përbërë nga përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së dhe Komisionit Evropian. Kryesuesi i Bordit Drejtues është një përfaqësues i një prej tri shteteve anëtare që marrin pjesë në presidencën e radhës me rotacion të Këshillit të BE-së. CEPOL ka njësi kombëtare në të gjitha shtetet anëtare, përmes të cilave ofron informacion dhe ndihmë për zyrtarët e policisë që dëshirojnë të marrin pjesë në aktivitetet e tij.

CEPOL dhe Ballkani Perëndimor

CEPOL ka vendosur me Ballkanin Perëndimor (WB6) aranzhime pune, dhe gjatë viteve të fundit ka organizuar dhe kryer trajnime, kurse, uebinare dhe programe shkëmbimi të shumta për tema të caktuara, të tilla si p.sh. pastrimi i parave, migracioni, hetimi financiar dhe terrorizmi.

PYETJE:

1. Cilat janë shërbimet kryesore që i ofron CEPOL?
2. Për cilin shtet anëtar të BE-së nuk është detyruese Rregullorja e Themelimit të CEPOL?
3. Kush e kryeson Bordin Drejtues të CEPOL?

BURIMET NË INTERNET:

[Rregullorja për themelimin e CEPOL-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e CEPOL-it](#)

[Skema organizative e CEPOL-it](#)

[Raportet Vjetore të CEPOL-it](#)

[Partnerët dhe aktorët e interesuar](#)

Agjencia Evropiane për Kontrollin e Kufijve dhe Roje Bregdetare (FRONTEX)

Përmes sigurimit të mbështetjes teknike dhe ekspertizës, Agjencia Evropiane për Kontrollin e Kufijve dhe Roje Bregdetare (*FRONTEX*) ndihmon shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e bashkëngjitura në Shengen⁶ për të menaxhuar kufijtë e tyre të jashtëm, për të harmonizuar kontrollin e kufijve në të gjithë BE-në dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis organeve kufitare të shteteve anëtare të BE-së. Promovon, koordinon dhe zhvillon menaxhimin e kufijve evropianë në përputhje me Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore dhe konceptin e menaxhimit të integruar të kufijve. Agjencia është themeluar në vitin 2004 dhe puna e saj aktualisht rregullohet nga një Rregullore e miratuar nga Këshilli i BE-së dhe Parlamenti Evropian në vitin 2019. Selia e saj është në Varshavë, në Poloni.

Cilat janë prioritetet kryesore të *FRONTEX*?

Misioni i *FRONTEX* është të sigurojë, së bashku me shtetet anëtare, kufijtë e jashtëm që të janë të sigurta dhe të funksionojnë mirë. Detyrat kryesore të *FRONTEX* janë:

- të analizojë të dhënat në lidhje me situatën në kufijtë e jashtëm të BE-së dhe më gjerë, në mënyrë që të lehtësojë përcaktimin e formularëve të migracionit dhe të mbështesë shtetet anëtare në kontrollimin, ekzaminimin, identifikimin dhe marrjen e shenjave të gishtave të migrantëve;
- të koordinojë dhe organizojë operacione të përbashkëta dhe ndërhyrje të shpejta në kufijtë e jashtëm të BE-së në formën e ndihmës për Shtetet Anëtare, duke përfshirë emergjencat humanitare dhe shpëtimin në det;
- të përgatisë analiza të rreziqeve dhe vlerësime të cenueshmërisë për të vlerësuar aftësinë dhe gatishmërinë e shteteve anëtare për t'u përballur me sfidat në kufijtë e jashtëm;
- të ndihmojë shtetet anëtare në kthimin me forcë të personave që kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në lidhje me mundësinë e tyre të qëndrimit në BE;
- të mbështesë bashkëpunimin midis agjencive të zbatimit të ligjit, agjencive të tjera të BE-së dhe shërbimeve doganore në kufijtë detarë;
- të angazhohet për parandalimin e kontrabandës, trafikimit të qenieve njerëzore, terrorizmit dhe krimeve të tjera ndërkufitare; dhe
- të ofrojë ekspertizë në fushën e kontrollit të kufirit, me zhvillimin e programeve mësimore dhe kurseve të specializuara për rojet e kufijve në të gjithë Evropën.

FRONTEX nuk ka as pajisje dhe as roje kufitare. Kur bashkërendon operacionet e përbashkëta, shtetet anëtare të BE-së janë ato që vendosin rojet kufitare, anijet, avionët dhe burime të tjera në dispozicion të saj. Në të gjitha fushat e veprimtarisë - operacionet, analizat e rrezikut, trajnim, kërkim, zhvillim dhe kthim të migrantëve - *FRONTEX* vepron si koordinator i cili, me qëllim të avancimit të punës dhe shkëmbimit të praktikave më të mira, krijon rrjete të specializuara midis organeve kufitare të BE-së dhe vendeve të bashkëngjitura të Shengenit.

⁶ Vendet e bashkëngjitura të rajonit Shengen janë Islanda, Norvegjia, Zvicra dhe Lihtenshtajni.

Cilat lloje të mbështetjes i ofron FRONTEX?

FRONTEX ndihmon shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e bashkëngjitura në Shengen për të menaxhuar kufijtë e jashtëm të BE-së dhe për të luftuar kundër krimit ndërkufitar. Megjithëse kontrolli i rregullt i kufirit është përgjegjësi e vetme e shteteve anëtare, *FRONTEX* e drejton rolin e vet operativ kryesisht drejt:

- koordinimit të vendosjes së ekspertëve dhe pajisjeve teknike shtesë në zonat kufitare të ekspozuara ndaj presioneve më të mëdha; dhe
- forcimit të kapacitetit të shteteve anëtare në fusha të ndryshme që lidhen me kontrollin e kufijve, përfshirë trajnimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira.

Si menaxhohet FRONTEX?

FRONTEX menaxhohet nga Drejtori Ekzekutiv, i ndihmuar nga një zëvendës. Drejtori Ekzekutiv dhe zëvendësi i tij emërohen nga Bordi Drejtues.

Detyrat kryesore të Bordit Drejtues të *FRONTEX* janë kontrolli i punës së agjencisë, përgatitja e buxhetit dhe monitorimi i ekzekutimit të tij, si dhe sigurimi i transparencës në procesin e vendimmarrjes. Bordi përbëhet nga përfaqësues të organeve kufitare të 26 shteteve anëtare të BE-së dhe dy anëtarë të Komisionit Evropian. Përfaqësuesit e Islandës, Norvegjisë dhe Zvicrës (vendet e bashkëngjitura në Shengen) marrin pjesë në takimet e komisionit, por të drejtat e tyre të votimit janë të kufizuara.

Në përputhje me Rregulloren e Themelimit, *FRONTEX* është përgjegjës para Këshillit të BE-së dhe Parlamentit Evropian, ndërsa puna e tij mbikëqyret nga Komisioni Evropian.

FRONTEX dhe Ballkani Perëndimor

Si një rajon i rëndësishëm transit, Ballkani Perëndimor është një nga prioritetet kryesore të Agjencisë. Aranzhimet e punës janë bërë me të gjithë anëtarët e *WB6*, ndërsa marrëveshjet e statusit janë nënshkruar me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë. Kjo mundëson që *FRONTEX* të ofrojë ndihmë në menaxhimin e kufijve, por gjithashtu të kryejë operacione të përbashkëta dhe, bazuar në marrëveshje, të vendosë ekipet e saj në zonat në kufi me BE-në. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është të luftojë imigracionin e paligjshëm dhe krimin ndërkufitar, i cili nganjëherë përfshin sigurimin e një ndihme më të madhe teknike dhe operative në kufi. Iniciativa për të lidhur marrëveshje të ngjashme statusi ka filluar me Maqedoninë Veriore dhe Bosnjë dhe Hercegovinën, dhe ato aktualisht janë duke u finalizuar. *FRONTEX* nisi operacionin e tij të parë të përbashkët jashtë BE-së në maj 2019, që kishte si qëllim mbështetjen e Shqipërisë në kontrollin e kufijve të saj.

PYETJE:

1. Cili është misioni i *FRONTEX*?
2. A ka *FRONTEX* pajisjet dhe rojet kufitare të veta?
3. Ku ka nisur *FRONTEX* operacionin e vet të parë të përbashkët jashtë Bashkimit Evropian?

BURIMET NË INTERNET:

[Rregullorja për themelimin e FRONTEX-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e FRONTEX-it](#)

[Dokumenti i programit të FRONTEX-it 2019-2021](#)

[Raporti vjetor i FRONTEX-it për vitin 2018](#)

[Regjistri i dokumentacionit të disponueshëm publikisht të FRONTEX-it](#)

[Operacionet kryesore të FRONTEX-it](#)

Qendra Monitoruese Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave (EMCDDA)

Qendra Monitoruese Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave (EMCDDA) i ofron Bashkimit Evropian dhe shteteve të tij anëtare një përmbledhje të bazuar në fakte dhe të dhëna të problemeve të drogës në Evropë, si dhe një bazë të fortë provash për të mbështetur diskutimet mbi këtë temë. Përveç kësaj, EMCDDA ndihmon profesionistët dhe praktikuesit në këtë fushë për të identifikuar praktikat më të mira dhe rrugën drejt fushave të reja të kërkimit. Agjencia u krijua në vitin 1993 me një rregullore të Këshillit. Ajo funksionon që nga viti 1995 dhe selia e saj është në Lisbonë (Portugali).

Cilat janë prioritetet kryesore të EMCDDA?

Misioni i EMCDDA është të sigurojë informacion faktik, objektiv, të besueshëm dhe të krahasueshëm mbi drogat dhe varësinë ndaj drogave, mbi bazën e të cilit më pas merren vendime dhe veprime të bazuara në prova në BE dhe në shtetet anëtare.

Për të arritur këtë, EMCDDA:

- i ofron Bashkimit Evropian dhe shteteve të tij anëtare, në nivelin evropian, informacion mbi drogat, varësinë ndaj drogave dhe pasojat e kësaj varësie;
- mbledh, regjistron dhe analizon të dhëna për trendët e ndryshme në lidhje me përdorimin e drogave, si dhe për përdorimin e substancave psikoaktive të ligjshme dhe të paligjshme;
- ofron informacion mbi praktikat më të mira të shteteve anëtare të BE-së dhe lehtëson shkëmbimin e tyre.

Të mbledhur rreth mendimit unanim se informacioni cilësor është një parakusht për zhvillimin e një politike efektive në luftën kundër drogës, pjesëtarët e EMCDDA i bazojnë aktivitetet e tyre në vlerat kryesore të cilat i synojnë dhe të cilat janë: përsosmëria shkencore; integriteti dhe paanësia; fokusimi në konsumatorin dhe orientimi kah ofrimi i shërbimit; dhe efikasiteti dhe qëndrueshmëria.

Cilat janë shërbimet kryesore dhe llojet e mbështetjes që i ofron EMCDDA?

Fushat me prioritet të veprimtarisë së EMCDDA përfshijnë, ndër të tjera:

- monitorimin e situatës në lidhje me problemin e drogës, si dhe trendët në rritje dhe zgjidhjet e aplikuara kur bëhet fjalë për çështje të lidhura me drogën;
- vlerësimin e rrezikut të substancave të reja psikoaktive dhe mirëmbajtjen e një sistemi të shpejtë të marrjes së informacionit; dhe
- zhvillimin e mjeteve dhe instrumenteve që do ta bëjnë më të lehtë për Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare të tij monitorimin dhe vlerësimin e suksesit të politikave që zbatohen kur është në pyetje droga.

EMCDDA ka krijuar infrastrukturën dhe ka zhvilluar mjetet e nevojshme për të gjitha shtetet anëtare për të mbledhur të dhëna në një mënyrë uniforme dhe të harmonizuar. Të dhënat mblidhen nga 'pikat fokale' kombëtare, të cilat së bashku formojnë Rrjetin Evropian të Informacionit mbi Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave (Reitox). EMCDDA bashkëpunon me partnerë në nivelin e BE-së dhe në atë kombëtar dhe ndërkombëtar, por edhe me organizata dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë nga vendet fqinje dhe vendet që janë kandidatë për anëtarësim në BE.

Si menaxhohet Qendra Monitoruese Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave?

Struktura organizative e EMCDDA përbëhet nga drejtoria e cila e menaxhon atë, si dhe dy organe statutore – bordi drejtues dhe shkencor. Bordi Drejtues është organi kryesor kur bëhet fjalë për vendimmarrjen. Ai përbëhet nga një përfaqësues nga secili shtet anëtar i BE-së, Norvegjia dhe Turqia, dy përfaqësues nga Komisioni Evropian dhe dy përfaqësues të emëruar nga Parlamenti Evropian. Takohet të paktën një herë në vit dhe zgjedh kryesuesin për një periudhë tre vjeçare. Bordi Shkencor, i përbërë nga pesëmbëdhjetë shkencëtarë të shquar të emëruar nga Bordi Drejtues, ndihmon Bordin Drejtues dhe Drejtorin e EMCDDA me dhënien e mendimeve për çështje shkencore në lidhje me punën e agjencisë. Drejtori emërohet nga Komisioni Evropian dhe emërohet nga Bordi Drejtues për një periudhë të rinovueshme prej pesë vjetësh.

EMCDDA dhe Ballkani Perëndimor

EMCDDA mbështet Komisionin Evropian në procesin e pranimit dhe ndihmon anëtarët e WB6 të përgatiten për pjesëmarrjen e tyre të ardhshme në punën e agjencisë. Bashkëpunimi i deritanishëm është realizuar kryesisht në kuadër të projektit të bashkëpunimit teknik me vendet përfituese të fondeve IPA. Në shkurt 2019, EMCDDA publikoi një raport kushtuar rajonit me titull "[Mënyrat e mjekimit nga droga në Ballkanin Perëndimor: rezultatet e hulumtimit të përbashkët të EMCDDA-UNODC të institucioneve për mjekim nga droga](#)", në të cilin paraqitet një përmbledhje e shkurtër e gjetjeve kryesore të hulumtimit të kryer në vitin 2017 në temën e mjekimit nga droga. Raporti teknik "[Droga dhe pasojat e saj në Ballkanin Perëndimor 2006-2014](#)" u publikua në vitin 2015 dhe ishte i pari që dha një pasqyrim të problemeve të shkaktuara nga droga me të cilat përballlet rajoni. Ai bazohet në të dhënat e disponueshme të mbledhura nga një numër partnerësh dhe EMCDDA. EMCDDA ka përgatitur gjithashtu raporte kombëtare për drogën në rajonin e WB6 për vitet 2013, 2014 dhe 2017.

PYETJE:

1. Cilat janë vlerat kryesore të *EMCDDA*?
2. Cilat janë aktivitetet kryesore të *EMCDDA*?
3. Çka është Reitox?

BURIMET NË INTERNET:

[Rregullorja për themelimin e EMCDDA](#)

[Faqja zyrtare e internetit e EMCDDA](#)

[Portali me praktikat më të mira](#)

[Strategjia EMCDDA 2025](#)

[Dokumenti i programit EMCDDA për periudhën 2020-2022](#)

[Raporti Vjetor i EMCDDA për vitin 2018](#)

[Baza e të dhënave e EMCDDA](#)

[Buletini Statistikor i EMCDDA](#)

Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF)

Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (*OLAF*) heton mashtrimet në lidhje me buxhetin e BE-së, si dhe korrupsionin dhe shkeljet e rënda të ligjit në institucionet e BE-së. Për më tepër, zhvillon edhe politikën kundër mashtrimit për nevojat e Komisionit Evropian. Megjithëse ka një status plotësisht të pavarur në kryerjen e hetimeve, *OLAF* është pjesë e Komisionit Evropian dhe i raporton Komisionerit për Buxhet dhe Administratë (z. Johannes Hahn, Komisioni Evropian 2019-2024).

Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit është i vetmi organ i BE-së i autorizuar për të zbuluar, hetuar dhe parandaluar mashtrimet në lidhje me fondet e BE-së. Ajo është gjithashtu organi kryesor i autorizuar për të hetuar korrupsionin dhe shkeljet e rënda të ligjit nga stafi i BE-së dhe anëtarët e institucioneve të BE-së. Ajo luan rol të rëndësishëm në sigurimin e integritetit të stafit të BE-së, që është parakusht për funksionimin efikas të institucioneve të Bashkimit Evropian.

Cilat janë aktivitetet kryesore të OLAF?

Për të përmbushur misionin e vet, *OLAF*:

- kryen hetime të pavarura në raste mashtrimi dhe korrupsioni në lidhje me fondet e BE-së;
- heton raste të shkeljeve të rënda të ligjit nga stafi i BE-së dhe anëtarët e institucioneve të BE-së;
- zhvillon politikë të BE-së kundër mashtrimeve.

OLAF hap hetime bazuar në të dhënat e marra nga burime të shumta private dhe publike.

Hetimet kanë të bëjnë me mashtrim, korrupsion dhe akte të tjera që prekin interesat financiare të BE-së kur bëhet fjalë:

- për të ardhurat nga buxheti i BE-së (kryesisht çështje të mashtrimit doganor);
- për të gjitha shpenzimet e tjera të BE-së (shpenzimet që përfshijnë fondet strukturore, fondet për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale, shpenzimet direkte, ndihma të jashtme për vendet që nuk janë anëtare të BE-së dhe qarkullimin e paligjshëm të produkteve të duhanit dhe mallrave të falsifikuara);
- për sjellje të pahijshme të stafit të BE-së dhe anëtarëve të institucioneve të BE-së.

Kur hapet një rast, ai mund të përshkruhet si hetim i brendshëm (hetim administrativ brenda një institucioni ose organi të BE-së), hetim i jashtëm (hetim administrativ jashtë një institucioni ose organi të BE-së) ose një rast që kërkon koordinim. Në këtë lloj të fundit të rastit, *OLAF* ndihmon në hetimet e kryera nga organet kombëtare ose nga një departament tjetër i BE-së duke lehtësuar mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit dhe krijimin e kontakteve. Pas përfundimit të hetimit, përgatit një raport dhe një vlerësim të dëmit financiar. Nëse është e nevojshme, Drejtori i Përgjithshëm i *OLAF* miraton rekomandime në lidhje me veprimet konkrete që do të ndërmerren. Rekomandimet mund të jenë të natyrës financiare, gjyqësore, disiplinore ose administrative. Rekomandimet financiare u drejtohen institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të BE-së, ose organeve kompetente të atyre shteteve anëtare që sigurojnë ose administrojnë fondet e BE-së. Rekomandimet gjyqësore u drejtohen zyrave të prokurorëve kombëtar, ndërsa rekomandimet disiplinore u drejtohen organeve të autorizuara nga institucionet ose organet përkatëse të BE-së për të kryer procedura disiplinore. Rekomandimet administrative u drejtohen institucioneve, organeve, organizatave ose agjencive të BE-së dhe synojnë të eliminojnë mangësitë në procedurat administrative ose në legjislacion.

Përveç punës hetimore, *OLAF* kontribuon në zhvillimin e politikës cilësore të BE-së në luftën kundër mashtrimit duke mbështetur përgatitjen e nismave legjislative dhe rregullatore të Komisionit Evropian që synojnë parandalimin e mashtrimit si fenomen. Përveç kësaj, ndihmon Komisionin Evropian në zhvillimin dhe azhurnimin e strategjive kundër mashtrimit, në ngritjen e vetëdijes për çështjet e mashtrimit, dhe ofron trajnime dhe seminare të ndryshme për të luftuar këtë formë të veprimtarisë kriminale.

Aktorët kryesorë të *OLAF* në shtetet anëtare janë: organet kombëtare të zbatimit të ligjit, organet doganore dhe organet gjyqësore. Qytetarët dhe kompanitë private janë gjithashtu të rëndësishme, pasi ata shpesh e informojnë agjencinë për raste të mundshme të mashtrimit. *OLAF* bashkëpunon ngushtë me Parlamentin Evropian dhe Këshillin e BE-së.

Si menaxhohet *OLAF*?

Në krye të *OLAF* është Drejtori i Përgjithshëm, i cili është përgjegjës para Komisionerit për Buxhet dhe Administratë. Drejtori i Përgjithshëm ndihmohet nga Drejtorët e katër Drejtorive të *OLAF* (Hetimi I dhe II, Mbështetja në Hetim dhe Politika e Punës).

Sa i përket veprimeve hetimore, puna e *OLAF* mbikëqyret nga bordi mbikëqyrës i përbërë nga pesë ekspertë të pavarur. Për të forcuar pavarësinë e *OLAF*, bordi gjithashtu ka për detyrë të monitorojë kryerjen e hetimeve.

Skemën e plotë organizative të *OLAF* mund ta shihni [KËTU](#).

OLAF dhe Ballkani Perëndimor

Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit të nënshkuara midis BE-së dhe anëtarëve të WB6 i mundësojnë OLAF të kërkojë ndihmë në kryerjen e hetimeve, në përputhje me mandatin dhe fushëveprimin e vet.

PYETJE:

1. Cili është misioni i OLAF?
2. Çfarë lloje hetimi kryen OLAF?
3. Kush është përgjegjës për monitorimin e aktiviteteve hetimore që i zhvillon OLAF?

BURIMET NË INTERNET:

[Rregullorja për themelimin e OLAF-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e OLAF-it](#)

[Plani Strategjik i OLAF-it për periudhën 2016-2020](#)

[Raporti vjetor i OLAF-it për vitin 2018](#)

[OLAF-i në shifra](#)

Rrjeti Gjyqësor Evropian për Çështje Penale (EJN)

Rrjeti Gjyqësor Evropian për Çështje Penale (EJN) është rrjet i personave kombëtarë të kontaktit që shërben për të avancuar bashkëpunimin e shteteve anëtare të BE-së në çështjet penale. Është themeluar në vitin 1998 me synimin për të përmirësuar, në nivelin juridik dhe praktik, bashkëpunimin gjyqësor midis shteteve anëtare të BE-së për të luftuar krimin e rëndë, veçanërisht krimin e organizuar, korrupsionin, trafikun e drogës dhe terrorizmin. Puna e EJN u forcua më tej me vendimin e Këshillit të vitit 2008. EJN ka një sekretariat i cili është përgjegjës për administratën dhe selia e tij është në EUROJUST në Hagë (Holandë).

Cili është misioni i EJN?

EJN lehtëson bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale ashtu që:

- vepron si ndërmjetës aktiv;
- ofron informacion juridik dhe praktik për organet lokale kompetente;
- mbështet kërkesat për krijimin e bashkëpunimit gjyqësor;
- merr pjesë në krijimin e një kulture gjyqësore në BE; dhe
- bashkëpunon me rrjetet e tjera gjyqësore, vendet jo-anëtare të BE-së dhe partnerët nga fusha e drejtësisë në shkëmbimin e ekspertizës dhe praktikave më të mira në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale të krimit kompjuterik.

Si funksionon EJN?

EJN përbëhet nga një person kontakti i emëruar nga të gjitha shtetet anëtare nga organet përgjegjëse për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, gjyqësorin dhe organet e tjera kompetente që merren me krimin e organizuar, korrupsionin, trafikun e drogës ose terrorizmin. Komisioni Evropian ka të drejtë të emërojë një person kontakti për ato fusha që janë brenda kompetencës së tij.

Personat e kontaktit veprojnë si 'ndërmjetësues aktivë' që lehtësojnë bashkëpunimin gjyqësor midis shteteve anëtare të BE-së në çështjet penale ashtu që:

- ndihmojnë në krijimin e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet organeve kompetente;
- sigurojnë informacionin juridik dhe praktik të nevojshëm për të përgatitur kërkesa efektive për bashkëpunim gjyqësor; dhe
- angazhohen për organizimin e trajnimit për bashkëpunim në fushën e drejtësisë.

Përveç personit të kontaktit, të gjitha shtetet anëtare emërojnë nga dy korrespondentë kombëtarë. Njëri është përgjegjës për funksionimin e brendshëm të rrjetit, dhe tjetri është përgjegjës për vendosjen dhe azhurnimin e informacionit në faqen e internetit të *EJN*, si dhe për mjetet elektronike që *EJN* i përdorë.

Sekretariati i *EJN* është administrator i Rrjetit Gjyqësor Evropian.

EJN dhe Ballkani Perëndimor

EJN ka krijuar bashkëpunim dhe ka një person kontakti në Ballkanin Perëndimor (*WB6*), si në zyrat e prokurorëve dhe ministritë e drejtësisë, ashtu edhe - në disa raste - në organet e tjera kompetente. Personat e kontaktit nga Ballkani Perëndimor shpesh marrin pjesë në seanca plenare të *EJN*, që u jep atyre mundësinë për t'u takuar me kolegët dhe për të shkëmbyer përvoja.

PYETJE:

1. Cili është misioni i Rrjetit Evropian për Çështje Penale (*EJN*)?
2. Si funksionon *EJN*?
3. A marrin pjesë përfaqësuesit e *WB6* në punën e *EJN*?

BURIMET NË INTERNET:

[Vendimi për themelimin e *EJN*](#)

[Faqja zyrtare e internetit e *EJN*](#)

[Raporti i *EJN* për vitin 2017/2018](#)

[Bashkëpunimi i *EJN* me vendet që nuk janë anëtare të BE-së dhe rrjetet gjyqësore](#)

Rrjeti Evropian për Parandalimin e Krimit (EUCPN)

Qëllimi i Rrjetit Evropian për Parandalimin e Krimit (*EUCPN*) është për të lidhur dhe mbështetur ekspertët në nivelin lokal, kombëtar dhe evropian, si dhe për të promovuar njohuri dhe praktikë në fushën e parandalimit të krimit midis shteteve anëtare të BE-së. *EUCPN* kontribuon në zhvillimin dhe promovimin e një qasje multidisiplinare dhe parandaluese ndaj veprimtarisë kriminale dhe ndjenjës së pasigurisë që ndodh në Evropë si pasojë e saj. Selia e Sekretariatit të *EUCPN* është në Bruksel.

Rrjeti u krijua në vitin 2001 me një vendim të Këshillit. Qëllimet kryesore të tij janë:

- të shërbejë si pikë referimi për grupet e synuara (përkatësisht praktikuesit dhe politikëbërësit në nivelin lokal dhe kombëtar, agjencitë përkatëse ndërkombëtare dhe të BE-së, organizatat dhe grupet e punës);
- të ndajë ekspertizën mbi parandalimin e krimit me të tjerët;
- të mbështesë punën në parandalimin e krimit në nivelin kombëtar dhe lokal;
- të kontribuojë në politikat dhe strategjitë e BE-së për parandalimin e krimit; dhe
- të merr pjesë në forma të ndryshme të parandalimit të krimit, në lidhje me prioritetet strategjike të BE-së.

Cilat janë aktivitetet kryesore të EUCPN?

Aktivitetet e *EUCPN* synojnë:

- zgjerimin e bazës së të dhënave të *EUCPN* (praktikës së mirë, politikës, hulumtimit);
- përgatitjen e fushatave për parandalimin e krimit;
- hulumtimin për parandalimin e krimit;
- krijimin e grupeve të ndryshme të mjeteve, dokumenteve parimore dhe buletineve;
- përfaqësimin e jashtëm të *EUCPN* dhe promovimin e parandalimit të krimit; dhe
- organizimin e takimeve dhe punëtorive me ekspertë dhe aktorë të ndryshëm.

EUCPN përcakton aktivitetet e veta në bazë të qëllimeve strategjike dhe i miraton ato për një periudhë prej një viti. *EUCPN* organizon një konferencë vjetore në të cilën shkëmbehen dhe ndahen përvojat dhe njohuritë në lidhje me praktikat më të mira në fushën e parandalimit të krimit dhe përmirësimit të sigurisë në shtetet anëtare të BE-së.

Si funksionon EUCPN?

Organi kryesor i *EUCPN* është një bord i përfaqësuesve kombëtarë, i përbërë nga një kryesues, një bord ekzekutiv dhe përfaqësues kombëtarë. Të gjitha shtetet anëtare emërojnë nga një përfaqësues dhe një alternativ për të marrë pjesë në takime të *EUCPN*. Bordi mblidhet të paktën dy herë në vit dhe është përgjegjës për pranimin e raportit strategjik të Rrjetit, implementimin e programit vjetor dhe miratimin e raportit

vjetor. Kryesuesi i *EUCPN*, si në Këshillin e BE-së, ndërrohet çdo gjashtë muaj. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga dy përfaqësues kombëtarë (të zgjedhur nga Bordi për një periudhë prej 18 muajsh) dhe përfaqësues kombëtarë nga presidencat e mëparshme, aktuale dhe dy të ardhshme të Këshillit të BE-së. Një përfaqësues i Komisionit Evropian merr pjesë në takimet e Bordit Ekzekutiv dhe Bordit të Përfaqësuesve Kombëtarë si vëzhgues.

Sekretariati e përfaqëson *EUCPN* para të tjerëve dhe i ofron mbështetje të përgjithshme administrative, teknike dhe analitike. Përmes dhënies së granteve, puna e Sekretariatit financohet nga Fondi për Siguri të Brendshme (*ISF*).

PYETJE:

1. Cilat janë aktivitetet kryesore të *EUCPN*?
2. Kush merr pjesë në punën e Bordit Ekzekutiv të *EUCPN*?
3. Si financohet sekretariati i *EUCPN*?

BURIMET NË INTERNET:

[Vendimi për themelimin e *EUCPN*](#)

[Faqja zyrtare e internetit e *EUCPN*](#)

[Plani i punës i *EUCPN* për vitin 2020](#)

[Qendra e njohurive e *EUCPN*](#)

Agjencia e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Sistemeve të Mëdha Informative në Fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë (eu-LISA)

Agjencia e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Sistemeve të Mëdha Informative në Fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë (eu-LISA) mbështet zbatimin e politikës së BE-së për drejtësinë dhe punët e brendshme përmes menaxhimit me sisteme të mëdha të TI, veçanërisht në fushat e azilit, menaxhimit të kufijve dhe politikës së migracionit.

Agjencia është e përkushtuar të ofrojë shërbime dhe zgjidhje me cilësi të lartë dhe efikase të TI-së, në mënyrë që të përmirësojë vazhdimisht kapacitetin e saj teknologjik në përputhje me nevojat e shteteve anëtare dhe të rritet si një qendër, puna e së cilës shërben si shembull. Ajo u krijua në vitin 2011, me një rregullore të Këshillit të BE-së dhe Parlamentit Evropian, ndërsa filloi të punojë në vitin 2012. Mandati i agjencisë është zgjeruar me një rregullore të re të vitit 2018. Selia e saj është në Talin (Estoni), qendra operative në Strasburg (Francë), qendra rezervë në Sankt Johann im Pongau (Austri) dhe zyra ndërlidhëse në Bruksel (Belgjikë).

Cilat janë aktivitetet kryesore të agjencisë eu-LISA?

Aktivitetet kryesore të agjencisë janë:

- menaxhimi i punës së gjeneratës së dytë të [Sistemit Informativ të Shengenit \(SIS II\)](#), [Sistemit Informativ për Viza \(VIS\)](#) dhe të [EURODAC](#);
- zhvillimi i [Sistemit Evropian për Regjistrimin e Hyrjes/Daljes \(EES\)](#), [Sistemit Evropian për Informata dhe Autorizime të Udhëtimit \(ETIAS\)](#) dhe [Sistemit Informativ të Regjistrave Penal Evropian për shtetasit e vendeve që nuk janë anëtare të BE-së \(ECRIS-TCN\)](#) dhe menaxhimin e atyre sistemeve;
- sigurimi i nivelit më të lartë të mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë së informatave;
- hulumtimi, zhvillimi dhe zbatimi i sistemeve të reja;
- dërgimi i planeve të trajnimit tek organet kombëtare për përdorimin teknik të sistemeve të TI-së; dhe
- dërgimi i statistikave dhe informatave në kohë dhe të sakta në lidhje me performancën e sistemeve.

Të gjitha aktivitetet kryhen në përputhje me vlerat themelore për të cilat angazhohet eu-LISA, të cilët janë: përgjegjësia, transparencë, puna me cilësi të lartë, vazhdimësia, puna në ekip dhe përqendrimi në përdoruesin. Këto sisteme ofrojnë mundësinë për shkëmbim të pandërprerë dhe të papenguar të të dhënave ndërmjet organeve kombëtare që i përdorin ato dhe për këtë arsye është e nevojshme që ato të punojnë si duhet 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

Si funksionon eu-LISA?

Struktura e agjencitë përbëhet nga Bordi Drejtues, një Drejtor Ekzekutiv dhe grupe këshilluese. Bordi Drejtues përbëhet nga përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së dhe Komisioni Evropian, ndërsa përfaqësuesit e *EUROJUST*, *EUROPOL* dhe vendeve të bashkëngjitura në Shengen (Zvicra, Islanda, Norvegjia dhe Lihtenshtajni) marrin pjesë si vëzhgues. Drejtori Ekzekutiv, i cili është përfaqësuesi ligjor i Agjencisë, si dhe zëvendësi i tij, emërohen nga Bordi Drejtues.

Strukturën e plotë organizative të eu-LISA mund të shihni [KËTU](#).

eu-LISA dhe Ballkani Perëndimor

Të gjitha konsullatat e vendeve anëtare të Shengenit të vendosura në rajonin e WB6 përdorin Sistemin Informativ të Vizave (VIS) që nga viti 2014, respektivisht bazën qendrore e cila i shërben organeve të vendeve anëtare të Shengenit për shkëmbimin e të dhënave për vizat afatshkurtra (të lëshuara për një periudhë deri në tre muaj). Sistemi shërben vetëm për ata persona që kanë nevojë për vizë për të hyrë. Sistemi i ri i hyrjeve dhe daljeve do të përdoret për të regjistruar të dhëna për hyrjet, daljet dhe kërkesat e refuzuara për hyrje të personave që janë shtetas të vendeve që nuk janë anëtare të BE-së dhe që kalojnë kufijtë e jashtëm të rajonit Shengen. eu-LISA është ajo që, në bashkëpunim me shtetet anëtare, do të zhvillojë këtë sistem, i cili pritet të fillojë të funksionojë në vitin 2020.

PYETJE:

1. Për cilat sisteme është përgjegjëse *eu-LISA*?
2. Kush merr pjesë si vëzhgues në mbledhjet e Bordit Drejtues të *eu-LISA*?
3. Ku gjendet selia e *eu-LISA*?

BURIMET NË INTERNET:

[Rregullorja për themelimin e eu-LISA](#)

[Faqja zyrtare e internetit e eu-LISA](#)

[Strategjia e eu-LISA për periudhën 2018-2022](#)

[Dokumenti Unik i Programit eu-LISA, 2020-2022](#)

[Raport për aktivitetet e eu-LISA për vitin 2018](#)

Instrumentet e Bashkimi Evropian për Luftën kundër Krimin të Organizuar

Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar në BE (SOCTA)

Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar (SOCTA) është një nga raportet kryesore strategjike të EUROPOL-it i cili shërben për të vlerësuar dhe përcaktuar prioritetet kur bëhet fjalë për kërcënime, cënueshmëri dhe mundësi për veprimtari kriminale. Raporti përmban një analizë të hollësishme të krimin të rëndë dhe të organizuar që kërcënon Bashkimin Evropian dhe është menduar për ata që punojnë në terren, për të gjithë pjesëtarët e agjencive të zbatimit të ligjit, për vendimmarrësit dhe publikun e gjerë. Në raportin SOCTA identifikohen fushat prioritare të veprimtarisë kriminale për të cilat duhet të synohen veprimet operative të BE-së.

Si përgatitet raporti SOCTA?

Raporti i parë SOCTA u publikua në vitin 2013 dhe u përgatit në përputhje me [metodologjinë](#) e re të zhvilluar gjatë periudhës 2011-2012. Metodologjia përfshin teknika analitike cilësore dhe sasore, si dhe një grup indikatorësh të përcaktuar qartë, të përdorur për të kuptuar më mirë krimin e rëndë dhe të organizuar. Para kësaj, nga viti 2006 deri në vitin 2011, ishin përgatitur dhe publikuar pesë Vlerësime të Kërcënimit të Krimin të Organizuar (OCTA).

Procesi i hartimit të raportit SOCTA përfshin përgatitjen dhe miratimin e metodologjisë, mbledhjen e të dhënave, analizën e të dhënave, përpunimin e vetë raportit dhe përcaktimin e prioriteteve të rekomanduara.

Analiza SOCTA kryesisht merret me:

- krimin e rëndë dhe të organizuar në BE;
- grupe të organizuara kriminale ose individë të përfshirë në veprimtari kriminale; dhe
- faktorë të pranishëm në një mjedis më të gjerë që mund të ndikojnë në formësimin e natyrës së krimin të rëndë dhe të organizuar në BE.

Rezultatet e analizës gjithëpërfshirëse të kërcënimeve me të cilat përballet BE-ja paraqiten në formën e një grupi rekomandimesh mbi bazën e të cilave Këshilli i BE-së përcakton dhe definojnë prioritetet dhe planifikon veprimet operative.

SOCTA krijohet si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë midis EUROPOL-it, organeve përgjegjëse për zbatimin e ligjit në shtetet anëtare, agjencive dhe organeve të BE-së, si dhe bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe me vendet që nuk janë anëtare të BE-së, por me EUROPOL-in kanë lidhur marrëveshje strategjike ose operative.

SOCTA 2017

EUROPOL-i e ka publikuar raportin më të fundit SOCTA në vitin 2017. Në të cekën trendët ekzistuese dhe të pritshme me të cilat përballet BE-ja në lidhje me krimin e rëndë dhe të organizuar, si dhe grupet kryesore dhe individët e përfshirë në krim në BE. Faktorët që formojnë natyrën e krimit të rëndë dhe të organizuar në Bashkim Evropian janë përcaktuar gjithashtu. Dokumenti identifikon tetë kërcënime prioritare kur bëhet fjalë për veprimtari kriminale: krimi kompjuterik; prodhimi, distribuimi dhe tregtimi i drogës; trafikimi i migrantëve; krimi i organizuar i pronës; trafikimi i qenieve njerëzore; financat kriminale dhe pastrimi i parave; mashtrimet në lidhje me falsifikimin e dokumenteve; dhe tregtimi i mallrave dhe shërbimeve të paligjshme në internet.

SOCTA dhe Ballkani Perëndimor

Në vitin 2015, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë publikoi të parin [Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Rëndë dhe të Organizuar \(SOCTA\)](#). Dokumenti është përgatitur në përputhje me metodologjinë e EUROPOL-it dhe është një pasqyrë strategjike e krimit të rëndë dhe të organizuar në shtetin tonë. Fushat e shqyrtuara përfshijnë drogën, migracionin e paligjshëm, trafikimin me qenie njerëzore, pastrimin e parave, korrupsionin, krimin ekonomik, krimin kompjuterik dhe grupet e krimit të organizuar. Vlerësimi Rajonal i Kërcënimit të Krimit të Rëndë dhe të Organizuar është përpunuar me mbështetjen e OSBE-së dhe ofron një analizë gjithëpërfshirëse të situatës dhe trendëve aktuale, si dhe kërcënimeve më të mëdha për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

PYETJE:

1. Kur është përgatitur raporti i parë SOCTA?
2. Kush merr pjesë në përgatitje të raportit SOCTA?
3. Cilat janë kërcënimet kryesore, prioritare të përcaktuara në raportin SOCTA për vitin 2017?

BURIMET NË INTERNET:

[Metodologjia SOCTA](#)

[Faqja zyrtare e internetit e EUROPOL-it](#)

[Raporti SOCTA për vitin 2017](#)

[SOCTA 2017, versioni në internet](#)

[Raporti SOCTA për 2013/Raportet OCTA](#)

Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar në Internet në BE (iOCTA)

Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar në Internet (iOCTA) është një raport i EUROPOL-it në të cilin ceken zbulimet kryesore, kërcënimet e reja, por edhe trendët në lidhje me krimin kompjuterik që ndikon në menaxhim, në biznese dhe te qytetarët në të gjithë BE-në. Ai përmban rekomandimet më të rëndësishme për organet e zbatimit të ligjit dhe politikëbërësit, për t'i ndihmuar ata të përgatiten në mënyrë efektive dhe t'iu përgjigjen kërcënimeve të cilat i sjell me vete krimi kompjuterik.

iOCTA merret veçanërisht me ato fusha të krimit për të cilat është përgjegjëse Qendra Evropiane e Krimit Kompjuterik (EC3):

- krimet e kryera ekskluzivisht me ndihmën e kompjuterëve;
- shfrytëzimin seksual të fëmijëve përmes internetit; dhe
- mashtrimet lidhur me pagesa.

Si përgatitet raporti iOCTA?

Raporti iOCTA përgatitet nga EC3, e cila i merr të dhënat prej ekspertëve nga EUROPOL-i, shtetet anëtare të BE-së, organeve përgjegjëse për zbatim të ligjit brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian, si dhe prej partnerëve dhe aktorëve nga sektori privat dhe financiar dhe bashkësia akademike.

Raporti është i ndarë në kapituj që janë hartuar dhe përgatitur në mënyrë që ata:

- të tregojnë gjetjet kryesore nga viti raportues lidhur me fusha të caktuara të krimit kompjuterik;
- të identifikojnë trendët dhe zhvillimet e ardhshme; dhe
- të japin rekomandime.

Përveç kësaj, raporti iOCTA paraqet një përmbledhje të shkurtër të kërcënimeve nëpër rajone gjeografike dhe veprimtarinë e krimit kompjuterik në të pesë kontinentet.

iOCTA 2019

Edhe në raportin iOCTA për vitin 2019, përshkruhen dhe analizohen trendët e fundit dhe ndikimi aktual i krimit kompjuterik në BE, në tri fusha ku është e autorizuar EC3 për tu angazhuar. Për më tepër, konsiderohen edhe disa fusha të tjera: keqpërdorimi kriminal i 'anës së errët të internetit' (Dark Web-i) dhe konvergjenca e krimit kompjuterik dhe terrorizmit. Ekziston gjithashtu një kapitull i kushtuar faktorëve që shfaqen në një numër fushash të veprimtarisë kriminale por që, në vetvete, nuk janë domosdoshmërisht kriminale (p.sh. inxhinieri sociale, persona që transferojnë para të përfituara në mënyrë të paligjshme, keqpërdorim kriminal i kriptovalutave).

PYETJE:

1. Cila është tema kryesore e raportit *iOCTA*?
2. Kush e përgatit raportin *iOCTA*?
3. Sa shpesh publikohet raporti *iOCTA*?

BURIMET NË INTERNET:

[Raporti iOCTA për vitin 2019](#)

[Të gjitha raportet e iOCTA](#)

[Qendra Evropiane për Krim Kompjuterik \(EC3\)](#)

[Faqja zyrtare e internetit e EUROPOL-it](#)

Praktika e shkëmbimit të informatave në BE

Përkundër faktit që institucionet dhe agjencitë e BE-së nuk janë të autorizuara që vet të zhvillojnë hetime dhe veprime operative në fushën e zbatimit të ligjit - pasi këto janë përgjegjësi të shteteve anëtare - është e nevojshme të vendoset një bashkëpunim efektiv midis policisë dhe organeve të tjera kompetente të shteteve anëtare dhe i cili avancohet vazhdimisht me qëllim të parandalimit dhe luftës kundër krimit të rëndë ndërkufitar dhe terrorizmit në BE.

Parakusht për bashkëpunimin efektiv është që organeve të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera kompetente t'u sigurohet qasja në kohë në informacione dhe të dhëna korrekte, të sakta dhe të azhuruara. Përmes zbatimit të praktikës së shkëmbimit të informatave, organet kompetente të shteteve anëtare mund të kryejnë me sukses dhe me kohë aktivitete dhe veprime që synojnë parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprimtarisë kriminale.

Në vitet e fundit, BE-ja është përpjekur të zhvillojë mekanizma dhe korniza ligjore për të mbështetur dhe lehtësuar bashkëpunimin midis shteteve anëtare, që synojnë të arrijnë më shumë në punën e punëve të brendshme, veçanërisht në fushat e krimit ndërkufitar dhe luftës kundër terrorizmit. Programet e miratuara në nivelin e BE-së - [Programi i Hagës](#) (2005–2010) dhe [Programi i Stokholmit](#) (2010–2015) - janë përcaktuar si prioritete dhe mënyra të shkëmbimit të informatave, si dhe instrumente të bashkëpunimit.

Këto prioritete, të përqendruara në interesat dhe nevojat e qytetarëve të BE-së, por edhe te personat e tjerë për të cilët BE-ja është përgjegjëse kur garanton sigurinë në Evropë, janë:

- përkushtimi për qytetarinë dhe të drejtat themelore;
- Evropa e ligjit dhe drejtësisë;
- Evropa që mbron;

- qasja në Evropë në botën e globalizuar;
- Evropa që është e përgjegjshme dhe solidare, dhe që punon në partneritet kur bëhet fjalë për migracionin dhe azilin; dhe
- roli i Evropës në botën e globalizuar - dimensionin e jashtëm.

Komisioni Evropian dhe agjencitë e BE-së, në bashkëpunim me shtetet anëtare, kanë hartuar dhe siguruar një numër mjeteve për të lehtësuar dhe përmirësuar shkëmbimin e informatave midis organeve të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera kompetente.

Më poshtë është një prezantim i shkurtër i mjeteve dhe mekanizmave që përdoren më shpesh.

Regjistri i Emrave të Udhëtarëve (PNR)

Regjistri i Emrave të Udhëtarëve (PNR) është krijuar në vitin 2016, me një direktivë të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Falë tij, shtetet anëtare marrin të dhëna për udhëtarët nga linjat ajrore dhe i përpunojnë ato me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të akteve terroriste dhe krimeve të rënda. Përmes operimit në një mënyrë të caktuar (përmes rezervimeve dhe check-in-it para ngritjes), linjat ajrore mbledhin të dhëna të tilla si datat e udhëtimit, itineraret, informatat e biletave, detajet e kontaktit, agjencitë e udhëtimit, mënyrat e pagesës, numrat e ulëseve dhe të dhënat për bagazhin. Rregullat zbatohen për aeroplanët që arrijnë në shtetet anëtare të BE-së nga vendet që nuk janë anëtare. Shtetet anëtare janë të detyruara të krijojnë subjekte speciale përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave, respektivisht Njësitë për Mbledhjen e Informatave të Udhëtarëve (NJPI).

Sistemi Informativ Evropian i Regjistrave Penal (ECRIS)

Sistemi Informativ Evropian për Mbledhjen e të Dhënave për Personat e Dënuar më parë është krijuar me [Vendim Kornizë të Këshillit](#), në vitin 2012. Vendimi u ndryshua në vitin 2019 me një [Direktivë të Parlamentit Evropian dhe Këshillit](#) për të siguruar mundësinë e shkëmbimit efektiv të informatave midis shteteve anëtare për personat e dënuar më parë në Bashkimin Evropian. Sistemi u siguron gjyqtarëve, prokurorëve dhe organeve kompetente në shtetet anëtare qasje më të lehtë në informata mbi historinë kriminale të të gjithë qytetarëve të BE-së, pavarësisht se në cilin shtet anëtar janë dënuar më parë.

Sistemi Evropian për Mbikëqyrjen e Kufijve (EUROSUR)

Sistemi për Mbikëqyrjen e Kufijve është krijuar me [Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të vitit 2013](#) për të përmirësuar bashkëpunimin midis shteteve anëtare dhe FRONTEX dhe për ndërgjegjësimin rreth situatës në terren dhe aftësinë për të reaguar në kufijtë e jashtëm. Ky bashkëpunim ndihmon në parandalimin e krimit ndërkuftar dhe migracionit të paligjshëm dhe përfshin të gjitha vendet e Shengenit si dhe Bullgarinë, Rumaninë dhe Kroacinë. Qendrat Kombëtare për Koordinim (NCC), për qëllime të koordinimit dhe shkëmbimit të informatave ndërmjet organeve të ngarkuara me kontrollin e kufijve të jashtëm, qendrave të tjera kombëtare të koordinimit dhe FRONTEX janë themeluar në të gjitha shtetet anëtare.

Sistemi Informativ për Luftë Kundër Mashtrimeve (AFIS)

Sistemi Informativ për Luftë Kundër Mashtrimeve menaxhohet nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimet (OLAF). Sistemi është platformë kryesore për shkëmbimin e të dhënave i cili iu shërben shërbimeve doganore për të luftuar kundër mashtrimeve, dhe synon që, bazuar në [Rregulloren për Ndihmën e Ndërsjellë](#), të mbështesë shërbimet doganore në luftën kundër krimit ndërkufitar. Përbëhet nga aplikacione të personalizuar të TI-së të dizajnuara për të lehtësuar bashkëpunimin e ndërsjellë midis organeve kombëtare dhe bashkëpunimin me Komisionin Evropian në zbatimin e ligjeve të BE-së të zbatueshme për doganat dhe produktet bujqësore.

Sistemi Informativ i Shengenit (SIS)

Sistemi Informativ i Shengenit (SIS), që është themeluar me [Vendim të Këshillit](#) nga viti 2007, është një sistem shkëmbimi i informatave i përdorur në Evropë për të menaxhuar sigurinë dhe kufijtë. Duke pasur parasysh mungesën e kontrollit në kufijtë e brendshëm, SIS ndihmon organet kompetente në të gjithë Evropën për të ruajtur dhe menaxhuar sigurinë e brendshme. Organet kompetente kombëtare, të tilla si policia ose rojet kufitare, marrin dhe fusin informata dhe paralajmërime për persona dhe objekte. Informatat nuk kanë të bëjnë vetëm me persona apo objekte konkrete specifike, por gjithashtu mund të përmbajnë udhëzime se çfarë të bëhet kur të gjenden ata persona/objekte. SIS përdoret në 30 vende evropiane, përfshirë 25 shtete anëtare të BE-së (në SIS nuk janë të kyçura ende vetëm Irlanda dhe Qipro), në katër vendet e bashkëngjitura në Shengen (Zvicër, Norvegji, Lihtenshtajn dhe Islandë) dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Kërkesa për informata shtesë gjatë hyrjes së personave në shtetet anëtare të BE-së (SIRENE)

Kërkesa për informata shtesë gjatë hyrjes së personave në shtetet anëtare të BE-së është elementi që është më i rëndësishëm për funksionimin efektiv të Sistemit Informativ të Shengenit (SIS). Të gjitha shtetet anëtare që janë të lidhura me SIS janë të detyruara të krijojnë një byro SIRENE, i cili punon 24 orë në ditë, 7 ditë në javë dhe i cili është përgjegjës për shkëmbimin e informatave shtesë dhe koordinimin e aktiviteteve në lidhje me paralajmërimet e lëshuara nga SIS. Rregullat dhe procedurat e hollësishme që zbatohen kur bëhet fjalë për këtë lloj bashkëpunimi janë cekur në Manualin e SIRENE të botuar në bazë të [Vendimit Ekzekutiv të Komisionit](#).

Aplikacioni i rrjetit për shkëmbim të sigurt të të dhënave (SIENA)

Aplikacioni i rrjetit për shkëmbim të sigurt të të dhënave është një platformë e EUROPOL-it. I nisur në vitin 2009, aplikacioni mundëson komunikim dhe shkëmbim të shpejtë të të dhënave operative dhe strategjike dhe informatave midis zyrtarëve të ndërlidhjes, analistëve dhe ekspertëve të Europolit, shteteve anëtare dhe palëve të treta me të cilët EUROPOL-i ka marrëveshje bashkëpunimi.

Vendimi Prum nga Prum (Prüm)

[Vendimi nga Prum](#) është një vendim i marrë nga Këshilli në vitin 2008 për të rritur bashkëpunimin ndërkufitar midis policisë dhe organeve gjyqësore të shteteve anëtare të BE-së në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndërkufitar. Ai përmban dispozita sipas të cilave shtetet anëtare i japin njëra-tjetrës qasje në skedarët e automatizuar të ADN-së, në sistemet e automatizuara të identifikimit të gjurmëve të gishtave dhe në të dhënat e regjistrimit të automjeteve.

Iniciativa suedeze

[Iniciativa suedeze](#) është një Vendim Kornizë i Këshillit i vitit 2006, që krijon një kornizë ligjore për të lehtësuar shkëmbimin e informatave dhe inteligjencës midis organeve të zbatimit të ligjit në shtetet anëtare të BE-së. Falë tij, procedurat e nevojshme për shkëmbimin ndërkufitar të informatave mbi aktivitetin kriminal dhe të dhënave informative nuk janë as më të rrepta dhe as më komplekse sesa ato të përdorura tashmë në nivelin kombëtar. Përveç kësaj, ai përcakton kushtet për shkëmbimin e informatave, të tilla si p.sh. afatet kohore dhe arsyetimet e pranueshme në rast se një organ refuzon të ofrojë të dhënat.

PYETJE:

1. Si i mbledhin shtetet anëtare të BE-së të dhënat e udhëtarëve?
2. Cili sistem siguron funksionimin efikas të Sistemit Informativ të Shengenit (SIS)?
3. Çka është *EUROSUR*?

BURIMET NË INTERNET:

[Rregullorja për futjen në përdorim të Regjistrit të Emrave të Udhëtarëve \(PNR\)](#)

[Vendimi Kornizë i Këshillit për themelimin e ECRIS-it](#)

[Rregullorja e vitit 2019 për ndryshimet dhe plotësimet në ECRIS](#)

[Rregullorja për futjen në përdorim të EUROSUR](#)

[Vendimet për krijimin e bashkëpunimit përmes sistemit SIRENE](#)

[Portali zyrtar i internetit i OLAF-it](#)

[Sistemi Informativ i Shengenit - SIS](#)

[Vendimi i Këshillit për futjen në përdorim të SIS II](#)

[SIENA – faqja zyrtare e internetit e EUROPOL-it](#)

[Vendimi nga Prum \(*Prüm*\)](#)

[Iniciativa suedeze](#)

Urdhër Arresti Evropian

Urdhër Arresti Evropian (EAW) është procedurë ligjore që thjeshton procedurën e dorëzimit dhe ekstradimit të personave nga një shtet anëtar i BE-së në një tjetër. Një urdhër i lëshuar nga organet gjyqësore të një shteti anëtar është në fuqi në të gjithë Bashkimin Evropian. Kjo do të thotë që shtetet anëtare nuk kanë të drejtë të refuzojnë të dorëzojnë shtetasin e tyre tek organet e një shteti tjetër anëtar nëse ai ose ajo ka kryer ose dyshohet të ketë kryer një krim në atë shtet anëtar tjetër. Urdhër Arresti Evropian është një mjet me të cilin gjyqësori lufton krimin dhe terrorizmin në Evropë në mënyrë më efektive.

[Rregullorja për themelimin dhe futjen në përdorim të EUROSUR](#)

[Vendimet për krijimin e bashkëpunimit përmes sistemit SIRENE](#)

[Portali zyrtar i internetit i OLAF-it](#)

[Sistemi Informativ i Shengenit - SIS](#)

Si funksionon Urdhër Arresti Evropian (EAW)?

Urdhër Arresti Evropian përdoret në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, me kontakt të drejtpërdrejtë midis organeve gjyqësore. Mekanizmi bazohet në parimin e njohjes reciproke të vendimeve gjyqësore, që do të thotë se urdhri zbatohet pa diskriminim dhe në të njëjtën mënyrë sikur arrestimi të ishte kërkuar nga organet përkatëse kombëtare. Kjo procedurë përshpejton ekstradimin e të dyshuarve dhe kriminelëve të dënuar nga një shtet anëtar në tjetrin, në mënyrë që ata të mund të gjykohen ose të vuajnë një dënim me burg në shtetin anëtar ku ata kanë kryer krimin.

Futja në përdorim e Urdhër Arrestit Evropian në janar 2004 eliminoi procedurat shpesh të gjata të ekstradimit të përdorura më parë nga shtetet anëtare.

Që kur Urdhër Arresti Evropian hyri në përdorim, organet gjyqësore të një shteti anëtar kanë 60 ditë pas arrestimit të një personi për të vendosur për ekstradimin e tij, me kusht që vendimi, nëse personi bie dakord të ekstradohet, duhet të merret brenda 10 ditësh. Në raste të caktuara, speciale - nëse ka kaluar shumë kohë që nga krimi dhe i dyshuari nuk mund të ndiqet më penalisht - shtetet anëtare mund të refuzojnë ekstradimin e personit të kërkuar.

Cilat janë kushtet për lëshimin e Urdhër Arrestit Evropian?

Urdhër arresti mund të lëshohet nga organet gjyqësore kombëtare nëse personi i kërkuar është:

- i akuzuar për një vepër penale të dënueshme me burgim për një vit ose më shumë; ose
- i dënuar me burgim për të paktën katër muaj.

Para lëshimit të urdhrit, organet gjyqësore në shtetet anëtare duhet të kryejnë një kontroll të proporcionalitetit. Kjo do të thotë që për secilin rast individual ata duhet të vlerësojnë dhe përcaktojnë peshën e veprës, kohëzgjatjen e dënimit, si dhe kostot dhe përfitimet e ekzekutimit të një urdhër arresti evropian.

Personat në lidhje me të cilët është lëshuar një urdhër i tillë kanë të drejta të caktuara procedurale, por edhe të drejta themelore që u garantohen atyre. Ata informohen me shkrim për të drejtat procedurale.

Këto të drejta përfshijnë:

- të drejtën për një interpret dhe përkthyes gjatë procedurave penale;
- të drejtën e të dyshuarit për tu informuar për të drejtat e tij;
- të drejtën për avokat dhe të drejtën e të paraburgosurve për të komunikuar me anëtarët e familjes dhe punëdhënësit;
- të drejtën për ndihmë juridike; dhe
- masat e mbrojtjes procedurale për fëmijët.

PYETJE:

1. Kush e lëshon urdhër arrestin evropian?
2. Cilat janë kushtet për lëshimin e urdhër arrestit evropian?
3. Cilat janë të drejtat procedurale të personave në lidhje me të cilët është lëshuar urdhër arresti evropian?

BURIMET NË INTERNET:

[Rregullorja për krijimin e urdhër arrestit evropian](#)

[Njoftimi i Komisionit - Manual se si të lëshohet dhe ekzekutohet një Urdhër Arrest Evropian](#)

[Urdhër Arresti Evropian në shifra, 2005-2017](#)

Urdhri Evropian për Inicimin e Hetimit

Urdhri Evropian për Inicimin e Hetimit (*EIO*) është një instrument ligjor të cilin organet gjyqësore të një shteti anëtar ia drejtojnë një shteti tjetër anëtar, duke kërkuar që ai të ndërmarrë një ose më shumë veprime hetimore në territorin e tij. *EIO* është themeluar në vitin 2014, me [Direktivën e Këshillit dhe Parlamentit Evropian](#). Ka filluar të përdoret në vitin 2017 dhe bazohet në parimin e njohjes reciproke, respektivisht në supozimin se hetimi do të zhvillohet pa diskriminim dhe në të njëjtën mënyrë siç është urdhëruar nga organi i shtetit anëtar në të cilin është dorëzuar urdhri. Instrumenti është i detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare të BE-së përveç Irlandës dhe Danimarkës.

Si funksionon EIO?

Qëllimi i Urdhrit Evropian për Inicimin e Hetimit është të lehtësojë mbledhjen ndërkufitare të provave në rastet penale duke i dhënë një shteti anëtar mundësinë për të kërkuar prova që gjenden në një shtet anëtar tjetër në çdo fazë të procedurës penale.

Shteti anëtar që lëshon urdhër arrestin evropian ka për detyrë ta përgatisë atë duke përdorur një formular standard dhe ta përkthejë atë në gjuhën e shtetit anëtar që ekzekuton urdhrin. Pas pranimit të urdhrin, organet kompetente të shtetit anëtar kanë 30 ditë për ta njohur atë dhe 90 ditë për të kryer të gjitha veprimet hetimore. Të gjitha provat e mbledhura gjatë hetimit, ose tashmë në posedim të organeve kompetente, do t'i dorëzohen pa vonesë shtetit anëtar që ka lëshuar urdhrin.

Para lëshimit të një urdhri të tillë, një shtet anëtar do të përcaktojë se ai është i nevojshëm dhe proporcional për sa i përket qëllimit të procedurës dhe se veprimet e specifikuar në urdhër mund të ishin urdhëruar edhe në territorin e tij nën të njëjtat kushte.

Përfshirjet nga lëshimi i një Urdhri Evropian për Inicimin e Hetimit

Urdhri Evropian për Inicimin e Hetimit nuk lëshohet kur bëhet fjalë për:

- themelimin e një ekipi të përbashkët hetimor (*JIT*) dhe mbledhjen e provave në kuadër të këtij ekipi;
- mbikëqyrjen ndërkufitare e cila ceket në Konventën për Zbatimin e Marrëveshjes së Shengenit;
- ngrirjen/sekuestrimin e fondeve/pasurisë me qëllim të konfiskimit;
- transferimin e personave për qëllime të ndjekjes penale.

Direktiva për futjen në përdorim të EIO gjithashtu përmban përfshirje të tjera në lidhje me informatat mbi dënimet e mëparshme, kthimin e objekteve të pala e dëmtuar, transferimin e procedurave, konfiskimin e pasurisë, bashkëpunimin midis organeve doganore dhe bashkëpunimin e ndërsjellë policor.

PYETJE:

1. Çka është urdhri evropian për inicimin e hetimit?
2. Cilat shtete anëtare të BE-së nuk janë të detyruara nga ky urdhër?
3. Cilat janë përfshirjet kur bëhet fjalë për lëshimin e këtij urdhri?

BURIMET NË INTERNET:

[Direktiva për futjen në përdorim të Urdhrit Evropian për Inicim të Hetimit](#)

[Faqja zyrtare e internetit e EUROJUST-it - Urdhri Evropian për Inicim të Hetimit](#)

[Organet kompetente në shtetet anëtare të BE-së, gjuhët që pranohen, çështjet urgjente dhe fushëveprimi i Direktivës për futje në përdorim të EIO](#)

Literatura shtesë

Brady, Hugo, and Roderick Parkes. "EU home affairs diplomacy: why, what, where – and how." *Chaillot Paper* no. 135 (July 2015): 7-57.

Busuioc, Dr. Madalina, *EU Justice and Home Affairs Agencies: Securing Good Governance*. Brussels: European Union, 2017.

Carrera, Sergio, and Elspeth Guild, Lina Vosyliūtė, Amandine Scherrer and Valsamis Mitsilegas. *The Cost of Non-Europe in the Area of Organised Crime*. Brussels: Centre for European Policy Studies, 2016.

Carrera, Sergio, and Guild Elspeth. *Implementing the Lisbon Treaty - Improving the Functioning of the EU on Justice and Home Affairs*. Brussels: European Union, 2015.

Deloitte. *How do EU agencies and other bodies contribute to the Europe 2020 Strategy and to the Juncker Commission Agenda?*. Brussels: Deloitte, 2016.

Di Nicola, Andrea, and Philip Gounev, Michael Levi, Jennifer Rubin, Barbara Vettor et al. *Study on paving the way for future policy initiatives in the field of fight against organized crime: the effectiveness of specific criminal law measures targeting organised crime*. Brussels: European Union, 2014.

Ernst & Young. *Independent external evaluation of the European Agency for the operational management of large-scale IT systems in the area of freedom, security and justice – eu-LISA*. Brussels: European Union, 2016.

Espina Ramos, Jorge A. "The European Investigation Order and its Relationship with Other Judicial Cooperation Instruments." *Eucrim*, no. 1 (January – May 2019): 53-60.

Eurojust. *Case Law by the Court of Justice of the European Union on the European Arrest Warrant*. The Hague: Eurojust, 2018.

European Commission. *Special Eurobarometer 499: Europeans' attitudes towards cyber security*. Brussels, European Union, 2020.

European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction and Europol. *EU Drug Markets Report 2019*. Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2019.

Europol and Eurojust. *Common challenges in combating cybercrime*. The Hague: Europol and Eurojust, 2019.

Gofas, Andreas (Editor). *Terrorism and European Security Governance*. Florence: European University Institute, 2018.

Grevi, Giovanni, and Daniel Keohane, Bernice Lee, Patricia Lewis. *Empowering Europe's Future: Governance, Power and Options for the EU in a Changing World*. Brussels: European Union, 2013.

Guerra, José Eduardo and Christine Janssens. "Legal and Practical Challenges in the Application of the European Investigation Order." *Eucrim*, no. 1 (January – May 2019): 46-53.

[Gutheil, Mirja, and Quentin Liger, Carolin Moller, James Eager, Max Henley, Yemi Oviolu. *EU and Member States' policies and laws on persons suspected of terrorism-related crimes*. Brussels: European Union, 2017.](#)

[ICF Consulting Services Ltd. *Final Report: External evaluation of the EMCDDA*. Brussels: European Union, 2018.](#)

[ICF in cooperation with Unisys. *Study on Advance Passenger Information \(API\) - Evaluation of Council Directive 2004/82/EC on the obligation of carriers to communicate passenger data*. Brussels: European Union, 2020.](#)

[ICF. *Study to assess the impacts related to possible evolutions of EUROSUR - Final Report*. Brussels: European Union, 2019.](#)

[Milt, Kristiina. *Briefing: Police cooperation achievements during the legislative term 2014-2019: the role of the European Parliament*. Brussels: European Union, 2019.](#)

[Policy Department for Citizens' Rights and Constitutional Affairs. *Interoperability of Justice and Home Affairs Information Systems*. Brussels: European Union, 2018.](#)

[PwC. *Feasibility Study for a European Travel Information and Authorisation System \(ETIAS\)*. Brussels: European Union, 2016.](#)

[van Ballegooij, Wouter, and Ivana Kiendl Krišto. *European Arrest Warrant - Framework for analysis and preliminary findings on its implementation*. Brussels: European Union, 2020.](#)

[van Ballegooij, Wouter. *The Cost of Non-Schengen: Civil Liberties, Justice and Home Affairs aspects*. Brussels: European Union, 2016.](#)

Bibliografia

Vendimi Ekzekutiv i Komisionit (BE) 2017/1528 i 31. 8. 2017 me të cilin zëvendësohet aneksi i Vendimit Ekzekutiv 2013/115/BE për Manualin *SIRENE* dhe masat e tjera të zbatimit të lidhura me Sistemin Informativ të Shengenit të gjeneratës së dytë (SIS II) (regjistruar si dokument C(2017) 5893), OJ L 231 i 7. 9. 2017, f. 6-51, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017D1528>

Njoftimi i Komisionit - Manual se si të lëshohet dhe ekzekutohet një Urdhër Arrest Evropian, OJ C 335, 6. 10. 2017, f. 1-83, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52017XC1006%2802%29>

Teksti i konsoliduar: Vendimi Kornizë i Këshillit 2006/960/JHA i 18. 12. 2006. për thjeshtimin e shkëmbimit të informatave dhe të dhënave informative midis organeve përgjegjëse për zbatimin e ligjit të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, OJ L 386, 29. 12. 2006, f. 98, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:02006F0960-20061230>

Teksti i konsoliduar: Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE, Euratom) nr. 883/2013 e 11. 9. 2013 mbi hetimet e kryera nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe për shfuqizimin e Rregullores (KE) nr. 1073/1999 dhe Rregullores së Këshillit (Euratom) nr. 1074/1999, OJ L 248 të 18. 9. 2013, f. 1, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:02013R0883-20170101>

Vendimi i Këshillit 2008/976/JHA i 16. 12. 2008 për Rrjetin Gjyqësor Evropian, OJ L 348, 24. 12. 2008, f. 130-134, në dispozicion në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L_.2008.348.01.0130.01.ENG

Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/841/JHA i 24. 10. 2008 për Luftën Kundër Krimit të Organizuar OJ L 300, 11. 11. 2008, f. 42-45, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008F0841&from=EN>

Vendimi i Këshillit 2009/316/JHA i 6. 4. 2009 për themelimin e Sistemit Evropian të Informatave për Regjistrat Penale (ECRIS) në zbatim të nenit 11 të Vendimit Kornizë 2009/315/JHA, OJ L 93, 7. 4. 2009, f. 33-48, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/GA/TXT/?uri=CELEX:32009D0316>

Vendimi i Këshillit 2009/902/JHA i 30. 11. 2009 për themelimin e Rrjetit Evropian për Parandalimin e Krimit (EUCPN) dhe shfuqizimin e Vendimit 2001/427/JHA OJ L 321 të 8. 12. 2009, f. 44-46, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A32009D0902>

Vendimi i Këshillit i 25 shkurt 2010 mbi themelimin e Komisionit të Përhershëm për Siguri të Brendshme, OJ L 52, 3 mars 2010, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32010D0131>

Dokumenti i Këshillit 12159/12, Metodologjia për Vlerësimin e Kërcënimit të Krimit të Rëndë dhe të Organizuar (SOCTA), Bruksel, 4. 7. 2012, në dispozicion në: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-12159-2012-INIT/en/pdf>

Dokumenti i Këshillit 14108/1/17 REV 1, *Draft raporti për Parlamentin Evropian dhe parlamentet kombëtare për punën e Komitetit të Përhershëm për Siguri të Brendshme* në periudhën nga korriku 2017 deri në dhjetor 2018, Bruksel, 11. 3. 2019, në dispozicion në: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-6818-2019-REV-1/en/pdf>

Dokumenti i Këshillit 8420/2/17REV2, *Draft konkluzionet e Këshillit për përcaktimin e prioritetëve të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar dhe të rëndë ndërkombëtar për periudhën 2018-2020*, Bruksel, 12. 5. 2017, në dispozicion në: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8654-2017-INIT/en/pdf>

Dokumenti i Këshillit 8810/2/17 REV 2, *Termtat e referencës për ciklin e politikës së BE-së*, Bruksel, i 5. 12. 2017, në dispozicion në: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10544-2017-REV-2/en/pdf>

Vendimi Kornizë i Këshillit 2006/960/JHA i 18 12. 2006 mbi thjeshtimin e shkëmbimit të informatave dhe të dhënave informative midis organeve të zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, OJ L 386, 29. 12. 2006, f. 89-100, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32006F0960>

Këshilli i Bashkimit Evropian. *EMPACT - Cikli i politikës së BE-së në luftën kundër krimit të organizuar dhe të rëndë ndërkombëtar*. Luksemburg: Shërbimi Botues i BE, 2018.

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) 2016/681 e 27. 4. 2016 për përdorimin e Regjistrit të Emrave të Udhëtarëve (PNR) për qëllime të parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprave terroriste dhe veprave të rënda penale, OJ L 119, 4. 5. 2016, f. 132-149, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2016/681/oj>

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2014/41/BE e 3. 4. 2014 mbi Urdhrin Evropian për Inicimin e Hetimit në Raste Penale, OJ L 130, 1. 5. 2014, f. 1-36, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32014L0041>

eu-LISA. *eu-LISA në vepër - Teknologjia informative në shërbim të një Evrope më të hapur dhe më të sigurt*. Luksemburg: Shërbimi Botues i BE-së, 2014.

Eurojust. Raporti vjetor i Eurojust për vitin 2018. Hagë: Eurojust, 2018.

Eurojust. *Dokumenti Unik Programit i Eurojust për periudhën 2020-2022*. Hagë: Eurojust, 2019.

Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit - Komisioni Evropian. Raporti i OLAF për vitin 2018. Luksemburg: Shërbimi Botues i BE, 2019.

Sekretariati i Rrjetit Gjyqësor Evropian. *Raporti i Rrjetit Gjyqësor Evropian për punën dhe menaxhimin për periudhën 2017-2018*. Hagë: Sekretariati i Rrjetit Gjyqësor Evropian, 2019.

Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave. *Strategjia e EMCDDA 2025* Luksemburg: Shërbimi Botues i BE, 2017.

Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave. *Raporti i përgjithshëm i punës për vitin 2018*. Luksemburg: Shërbimi Botues i BE, 2019.

Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave. *Dokumenti i programit EMCDDA për periudhën 2020-2022*. Luksemburg: Shërbimi Botues i BE, 2020.

Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit. *Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar në Internet (iOCTA) për vitin 2019*. Hagë: Qendra Evropiane për Luftën Kundër Krimit Kompjuterik EUROPOL/EC3, 2019.

EUROPOL. *Vlerësimi i kërcënimit të krimit të rëndë dhe të organizuar në Bashkimin Evropian për vitin 2017*. Hagë: EUROPOL, 2017.

EUROPOL. *EUROPOL shkurtimisht*. Hagë: EUROPOL, 2019.

EUROPOL. *Strategjia e Europol-it 2020+*. Vjenë: Informacion i disponueshëm publikisht nga Europol, 2018.

EUROPOL. *Dokumenti i programit të Europol për periudhën 2020-2021*. Hagë: Informacion i disponueshëm publikisht nga Europol, prill 2020.

FRONTEX. *Agjencia në shikim të parë*. Luksemburg: Shërbimi Botues i BE, 2019.

FRONTEX. *FRONTEX 2019 shkurtimisht*. Varshavë: FRONTEX, 2020.

Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (KE) nr. 1920/2006 e 12. 12. 2006 për Qendrën Evropiane të Monitorimit të Drogave dhe Varësisë ndaj Drogave (e ndryshuar), OJ L 376, 27. 12. 2006, f. 1-13, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32006R1920>

Rregullorja (BE) 2015/2219 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 11. 2015 për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Organeve të Zbatimit të Ligjit (CEPOL) që zëvendëson dhe shfuqizon Vendimin e Këshillit 2005/681/JHA, OJ L 319, 4. 12. 2015, f. 1-20, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32015R2219>

Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) 2016/794 e 11 5. 2016 për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (Europol) me të cilën zëvendësohen dhe shfuqizohen Vendimet e Këshillit 2009/371/JHA, 2009/934/JHA, 2009/935/JHA, 2009/936/JHA dhe 2009/968/JHA, OJ L 135, 24. 5. 2016, f. 53-114, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32016R0794>

Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) 2018/1726 e 14 11. 2018 për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Sistemeve të Mëdha Informative në Fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë (eu-LISA) që zëvendëson Rregulloren (KE) nr. 1987/2006 dhe Vendimin e Këshillit 2007/533/JHA dhe shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1077/2011 OJ L 295, 21. 11. 2018, f. 99-137, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX:32018R1726>

Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) 2018/1727 e 14 11. 2018 për Zyrën Evropiane për Drejtësi Penale (Eurojust) që zëvendëson dhe shfuqizon Vendimin e Këshillit 2002/187/JHA, OJ L 295, 21. 11. 2018, f. 138-183, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32018R1727>

Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) 2019/1896 e 13 11. 2019 për Kontrollin e Kufijve Evropian dhe Rojet Bregdetare, e cila shfuqizon Rregulloret (BE) nr. 1052/2013 dhe (BE) 2016/1624, OJ L 295, 14. 11. 2019, f. 1-131, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/1896/oj>

Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) nr. 1052/2013 e 22. 10. 2013 për themelimin e Sistemit Evropian të Mbikëqyrjes së Kufijve (Eurosur), OJ L 295, 6. 11. 2013, f. 11-26, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32013R1052>

Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE, Euratom) nr. 883/2013 e 11. 9. 2013 për hetimet e kryera nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), e cila shfuqizon Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (KE) nr. 1073/1999 dhe

Rregulloren e Këshillit (Euratom) nr. 1074/1999, OJ L 248, 18. 9. 2013, f. 1-22, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32013R0883>

Programi i Hagës: Forcimi i lirisë, sigurisë dhe drejtësisë në Bashkimin Evropian, OJ C 53, 3. 3. 2005, f. 1-14, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A52005XG0303%2801%29>

Programi i Stokholmit - Evropa e hapur dhe e sigurt që iu shërben qytetarëve dhe i mbrota, OJ C 115, 4. 5. 2010, f. 1-38, në dispozicion në: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex:52010XG0504\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex:52010XG0504(01))

Burimet në internet:

[Faqja zyrtare e internetit e DG HOME](#)

[Faqja zyrtare e internetit e Parlamentit Evropian](#)

[Faqja zyrtare e internetit e Këshillit të BE-së](#)

[Faqja zyrtare e internetit e EUROPOL-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e EUROJUST-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e CEPOL-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e FRONTEX-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e EMCDAA](#)

[Faqja zyrtare e internetit e OLAF-it](#)

[Faqja zyrtare e internetit e EJN-së](#)

[Faqja zyrtare e internetit e EUCPN-së](#)

[Faqja zyrtare e internetit e eu-LISA](#)



www.bezbednost.org